



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.07.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik organizon një takim me përfaqësues të Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë – Valorë RRTL, për të diskutuar në lidhje me problematikat dhe shqetësimet e operatorëve lokalë që kanë dalë nga procesi i digjitalizmit, të cilat ia ka adresuar këtij komisioni përmes një letre.

Marrin pjesë: Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Luçiano Boci, Luan Baci, Romeo Gurakuqi, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Edmond Isaku – kryetar i RRTL-së,

Lutfi Mecka – “TV Kuksi”,

Luftim Vani,

Arqile Gorea – “TV Adria”,

Fred Stakaj,

Albert Ilia - “6+1 Vlorë”,

Aristotel Petro – “RTV Alpo”, Gjirokastrë,

Artur Rustemi - “TV Apollonia”,

“TV Alpo”,

“TV Jug”,

“TV Lezha”,

Fejzo Subashi - “BBF”

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s,

Sami Nezaj – nënkryetar i AMA-s,

Suela Musta – anëtare e AMA-s,

Sara Xhumbari – drejtore Juridike e AMA-s,

Arben Muka – drejtor Programacioni i AMA-s,

Dritan Xhelili – shef Kabineti i AMA-s,

Henri Muça – drejtor teknik në RTSH,

Saimir Kumbaro – anëtar i KDRTSH.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Para disa ditësh Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka marrë një letër nga Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë –Valorë në lidhje me disa problematika të operatorëve lokalë, që kanë dalë nga procesi i digjitalizimit dhe ndihmën që kërkojnë nga institucionet përkatëse për zgjidhjen e tyre.

Sikurse e shikoni, ne, si komision, vendosëm që këtë mbledhje ta zhvillojmë ditën e parë të mundshme, pavarësisht se jeni në dijeni që sesioni parlamentar ka mbaruar dje. Gjithsesi, duke konsideruar që problematika që keni trajtuar në shkresën tuaj ishte shumë e rëndësishme dhe e mprehtë, jo vetëm për faktin e një rëndësie të madhe që i jepet lirisë së medias në të gjitha vendet, si një prerogativ jo vetëm për hapjen e negociatave, por edhe në procesin e integritetit, edhe për shkallën e demokratizimit të një vendi për mënyrën se si lajmi shkon te qytetarët.

Pa humbur kohë, do të doja t'ua jepja fjalën përfaqësuesve të transmetuesve lokalë, që të ngrenë disa prej shqetësimeve të tyre në mënyrë të përmbledhur. Të ftuar janë Kryetari i AMA-s dhe përfaqësues të bordit, gjithashtu edhe përfaqësues të Radiotelevizionit Shqiptar, në mënyrë që, nëse është e mundur, të kemi propozime për zgjidhje të paktën të një pjese të problematikave që keni ngritur.

Në ditët dhe javët në vijim, nëse është brenda funksionit të komisionit tonë, nëse do të ketë nevojë për ndërhyrje apo rregullime të ndryshme ligjore, sigurisht që do të jemi të hapur të ndërmarrim veprimet e duhura.

Cili do të flasë në emër të operatorëve lokalë?

Ju lutem, kur të merrni fjalën, prezantohuni si fillim dhe më pas kaloni në çështjet që do të trajtoni.

Faleminderit!

Edmond Isaku – Quhem Edmond Isaku, jam kryetari i shoqatës së Rrjetit të Televizioneve Lokale dhe Kabllorë.

Së pari, ju falënderoj shumë për vlerësimin që i bëtë këtij takimi dhe për shpejtësinë me të cilën reaguat për t'u mbledhur.

Letrat që kemi sjellë besoj se janë të qarta për shqetësimet tona. Nëse doni, jua lexoj përsëri, ose do të bëj një përmbledhje të pikave kryesore.

Shoqata jonë ka vite në funksion dhe ka qenë prezente në çdo takim që AMA dhe institucione të tjera kanë bërë në lidhje me problemin e procesit të digjitalizimit. Gjithmonë kemi dhënë mendimet tona, kemi qenë prezentë me fjalën tonë dhe sot jemi në një moment kur ky proces ka filluar dhe po vazhdon të implementohet. Problematikat që kanë dalë menjëherë sapo procesi ka filluar të implementohet, janë të mëdha.

Do t'ju bëj një përmbledhje të 4 problematikave, të cilat i kemi konsideruar si më seriozet në këtë proces: së pari, duke filluar me frekuencën lokale, e cila është parashikuar në ligjin për Radiotelevizionin.

Problemi tjetër është implementimi i televizioneve lokale në frekuencën e RTSH-së, e cila është lënë në dispozicion të këtyre televizioneve. Nuk biem dakord për tarifën e vendosur nga bordi drejtues i RTSH-së, për cilësinë e transmetimit që kërkon, që të hyjë në televizionet lokale.

Problemi tjetër i ndjeshëm është rimbursimi, pasi këto media janë jo më pak se 20 vjet në transmetim dhe procesi i digjitalizimit kërkon që gjithë teknologjia e përdorur deri tani, të hidhet dhe të kalohet në një transmetim tjetër dixhital bashkëkohor, i cili kërkon pagesë shtesë për këtë problem.

Janë probleme shumë të ndjeshme për ne. Sa për kureshtjen tuaj, po ju marr si shembull “TV-Korça”, i cili ka dalë nga transmetimi i platformës së RTSH-së vetëm pas dy muajsh në transmetim. Dje konfirmoi tërheqjen për arsye të një pagese të lartë, e cila nuk mund të përballohet nga televizionet lokale.

Problemi tjetër, të cilin e kemi ngritur disa herë, por nuk ka gjetur përkrahje, është reklama shtetërore. Televizionet lokale janë totalisht të përjashtuara nga kjo reklamë, a thua se nuk ekzistojnë fare, në një kohë që ato mbulojnë 100% të territorit të Shqipërisë dhe janë rrjet më i madh sesa një televizion kombëtar, publik apo cilido qoftë ai.

Reklama shtetërore është pjesë e të gjithë taksapaguesve, edhe ne jemi pjesë e saj dhe ajo duhet të ndahet sipas zonave të licencimit ose le të bëhet edhe matja e audiencës nga një institucion në varësinë tuaj dhe të nxirret me ekzaktesi ajo pjesë që u takon televizioneve lokale. Televizionet lokale nuk mund të shihen më si të njerkrës. Ato janë pjesë e këtij procesi, kanë filluar atëherë kur TVSH-ja nuk ishte në transmetim, e dini mirë ju të gjithë, televizionet lokale kanë qenë dritarja që kanë dhënë kontributin e tyre në të gjitha zonat ku kanë operuar dhe vazhdojnë të operojnë.

Asnjëherë nuk përmendet fakti që televizionet lokale janë historikë dhe duhet të përkrahen, por përmenden vetëm platformat, përmenden televizionet publike dhe kombëtare, të cilët i përkrahim dhe i falënderojmë për gjithçka që kanë bërë. Pra, ne mendojmë që ata duhet të shihen si pjesë e këtij procesi real dhe të marrin pjesën që u takon.

Për secilin nga problemet do të diskutojmë gjatë bisedës, por mendova t'i them në mënyrë të përmblodhur. Më pas, për secilin problem jemi gati t'i japim përgjigje qoftë TVSH-së, qoftë AMA-s apo cilitdo që ka pretendime lidhur me shqetësimet që ngrita.

Ju falënderoj për kohën që vutë në dispozicion tonë!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Nga informacionet që kam marrë dhe nga biseda që kemi bërë edhe me përfaqësuesit e AMA-s, ju keni pasur edhe një takim me ta para disa ditësh, në mos gaboj, me sa kuptoj ndoshta ka një lloj paqartësie për sa i përket platformës së televizioneve lokale.

Zoti Sala mund të na bëjë shkurtimisht një sqarim, para sa të vazhdojmë me të tjera problematika. Në takimin që keni pasur, a kanë gjetur zgjidhje pjesa e çështjeve që janë trajtuar, apo ka ndonjë propozim për zgjidhje?

Edmond Isaku – Në takimin që bëmë me kryetarin e AMA-s, u trajtuan të gjitha problemet dhe vendosëm që t'ju bëjmë juve një kërkesë, si institucioni më i lartë, që keni fuqinë qoftë për amendamente, ndryshim ligji etj., sepse disa probleme ndoshta nuk gjejnë zbatim tek AMA. Kështu që ramë dakord të bëjmë një kërkesë për ju, për t'i trajtuar këto probleme në një spektër më të gjerë, që të paktën të vendosen disa gjëra. Këto probleme nuk mund të kalohen gjithmonë duke ia lënë topin njëri-tjetrit.

Megjithatë, këtu është prezent edhe kryetari i AMA-s, i cili mund t'ju sqarojë për më tepër.

Albana Vokshi – Këtu kemi të ftuar edhe përfaqësuesit e AMA-s, edhe përfaqësuesit e RTSH-së, ndaj mendojmë që sot të bëjmë të paktën një lloj sqarimi për secilën nga problematikat.

Me sa kuptoj, tarifa është njëra prej problematikave që ju keni ngritur si një nga shqetësimet më të mëdha. Ju nuk keni qenë të përfshirë kur është bërë përcaktimi i tarifave për televizionet lokale.

Ndoshta përfaqësuesi i Radiotelevizionit mund të na sqarojë për procesin se si janë përcaktuar këto tarifa.

Rimbursimi është çështja tjetër. Çështje tjetër janë teknologjia, reklamat shtetërore dhe frekuencat.

Pra, zoti Sala mund të na thoni diçka më tepër në lidhje me takimin që keni pasur? Cilat janë problematikat që mund t'i trajtojmë këtu e t'u japim zgjidhje qoftë edhe të ndërmjetme afatshkurtër?

Një nga propozimet që kam marrë është edhe shtyrja e afatit, që keni lënë deri në datën 31 korrik. A ka mundësi të ketë shtyrje të afatit, për t'u lënë hapësirë frymëmarrjeje edhe televizioneve lokale? Nuk e di nëse është e mundur të bëhet kjo, por gjithsesi mund ta diskutojmë këtu.

Gentian Sala – Faleminderit, kryetare!

Ka histori e gjithë kjo; nuk shpjegohet dot me një fjali apo dy. Ideja është se nga subjekte që menaxhonin vetë shpërndarjen e rrjetit, pra jo kontentin, do të kalohet në pak subjekte, si gjithë vendet e tjera, që bëjnë menaxhimin e rrjetit. Normal që kjo sjell konflikte.

Vend ka për të gjithë, kjo është e padiskutueshme. Jo thjesht se është kërkesë ligjore, por edhe realisht në terren ka vend që asnjë operator të mos ngelë jashtë procesit. Problemi ngelet te zbatimi.

Kur kam ardhur unë në detyrë, të paktën, kam gjetur tarifa të tjera. Nuk besoj që është e vërtetë dhe asnjë nga operatorët nuk e mohon dot që nuk është pyetur apo konsultuar për tarifën. Janë bërë të paktën 3-4 takime me shoqatën, përveç dhjetëra takimeve që kemi pasur me grupe të vogla në zyrën time dhe në ambientet e përbashkëta. Pra, nuk besoj që në vitin 2016 kur është miratuar tarifa, shoqata e operatorëve nuk ka pasur dijeni. Ka shkresa dhe procesverbale që e vërtetojnë këtë.

Tarifa është ulur të paktën 30% në vitin 2016, kjo jo se AMA është treguar e dashur për t'i ulur këto tarifa për operatorët, por ka qenë një keqlllogaritje e bërë nga administrata e mëparshme e Radiotelevizionit dhe Autoriteti i Mediave. Nga diskutimet që janë bërë, edhe metodologjia ka qenë e gabuar, pasi i ndante zonat thjesht si blloqe: bllok qendror, bllok bregdetar etj. dhe nuk bënte ndarjen më të drejtë në bazë të popullsisë. Ky riorganizim bëri që tarifat të ulen, për shembull, Shkodra tani paguan 1113 euro, më parë ka paguar afro 2000 euro; Kukësi paguan 365 euro, në mos gabo, ka paguar 700-800 euro etj., etj. Pra, ulja është e konsiderueshme për mbartjen te RTSH-ja.

Le të kalojmë tek implementimi. Me implementimin po shohim që ka shumë probleme.

(Diskutim pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Të lutem, ia kam dhënë fjalën kryetarit, do t'jua jap edhe juve! Le t'i marrim me radhë çështjet, që t'i sqarojmë të gjitha.

Gentian Sala – Tek implementimi po dalin probleme. Në Korçë, jo të gjithë operatorët lokalë kanë kaluar, pasi kanë vështirësi për pagesat; në Berat po ashtu; në Fier po ashtu; nga 5 operatorë lokalë, vetëm njëri është mbartur te RTSH-ja.

Së pari, duhet të zbërthejmë këtë problem: pse ndodh kjo. Është vërtet problem tarife? Të mos harrojmë se RTSH-ja mund të ketë problemet e veta, por mbulimi me sinjal është shumë më i mirë. Në mos gabo, mbulimi me sinjal është njësoj si operatori publik. Në një zonë operatori publik ka të paktën 4-5 antena. Subjektet, të jemi realistë, janë mësuar me një antenë që vënë në zonën më të banuar, e cila nuk e shpërndan mirë sinjalin. Pra, të mos bëjmë njërin djall dhe tjetrin të mirë, por të shohim problemet me realitet.

Nga historiku di që RTSH-ja është pak e ngurtë te këto probleme, se ajo, në fund të fundit, bën matematikë: kaq harxhoj për karburant, kaq për mirëmbajtjen, kaq për antenën. Ne si Autoritet do të vendosim në bazë të asaj që është RTSH-ja. Nuk e bëjmë ne tarifën. Ne thjesht bëjmë një kontroll të atyre që thotë operatori publik dhe më pas vendoset tarifa. Nga ana procedurale, te kjo punë, është pak ajo çfarë mund të bëhet, mendoj unë. Megjithatë, ndoshta diskutimi nxjerr ato...

Albana Vokshi - ...mënyrën e përcaktimit të tarifave dhe pretendimet e transmetuesve lokalë në lidhje me tarifat e larta dhe moskonsultimin...

Henri Muça - Siç e tha edhe kryetari, konsultime ka pasur, por unë nuk i kam arritur se kanë ndodhur më shumë se dy vjet më parë por, në fakt, tarifat e televizioneve lokale janë llogaritur vetëm për kostot e mirëmbajtjes së rrjetit dhe jo për ndërtimin e tij.

Siç e ka strategjia, që nuk është shumë e qartë për kalimin e transmetimeve nga analoge në digjitale, operatorët mund të mbarten në 5 rrjetet e tjera, domethënë, kanë 6 multipleksa për t'u mbartur dhe, duke qenë privat, edhe ata mund të kenë kosto të tjera, sepse, siç tha edhe kryetari, ata janë me një transmetues të vetëm, ndërkohë që RTSH-ja ka 6. Në qoftë se rrjeti në total mund të ketë 10-15, ne kemi 59 transmetuesa, duke pasur edhe detyrimin ligjor për të mbuluar rreth 95% të popullsisë; në fakt, më shumë se 95 % e ka projekti që do të mbarojë për dy-tre muaj, ne e kemi më pak, si detyrim ligjor. Kështu që edhe kostot nuk janë njësoj si të tjerët. Në fakt, mbartja nuk është e përcaktuar apo me detyrim që të jetë pranë RTSH-së. Mund të jetë kudo, është e lirë dhe strategjia e ka përcaktuar shumë të qartë. Kështu që mos i bini në qafë RTSH-së për tarifat, e fiku apo e ndezi! Mund të shkoni ku të doni dhe ku ta mendoni ju. Është biznes privat.

(Diskutim pa mikrofon.)

Jo, në këtë fazë është privat, pastaj më vonë...

(Diskutim pa mikrofon.)

Unë nuk po flas si qytetar, po flas siç e ka strategjia dhe si janë mundësitë tuaja. Ne po zbatojmë strategjinë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Unë nuk mund të përgjigjem për RTSH-në, po them edhe si janë mundësitë.

Albana Vokshi – Pyetja ishte për tarifën, për mënyrën e përcaktimit të saj.

Henri Muça – Është e përcaktuar në strategji. Ne i kemi mbuluar detyrimet tona sipas strategjisë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Gentian Sala – Ideja është: si në asnjë vend tjetër të Europës, në Shqipëri operatori publik ka marrë në menaxhim dy rrjete, me të drejtë, për mendimin tim, pasi, duke pasur parasysh se është një treg shumë agresiv, operatorët e mëdhenj janë shumë të fuqishëm. Operatorët lokalë rrezikonin të ngelnin pa transmetim dhe ligjvënësi mendoi që operatori publik të menaxhojë edhe rrjetin që do të mbështesë operatorët lokalë, pra nuk mund të thuhet kaq kollaj që ky rrjet është i operatorëve dhe mund të shkoni ku të do doni. Rrjeti i dytë është komplet për operatorët lokalë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Në kuptimin e ligjit, është vendosur që në një rrjet të mbartet platforma e RTSH-së, e cila ka 12 kanale, dhe rrjeti tjetër të jetë vetëm për operatorët lokalë. Pra, parlamenti vendosi që operatorët lokalë të mos lihen në dorë të subjekteve të mëdha dhe tha që ky rrjet të jetë vetëm për ta.

Ky është thelbi, pastaj te tarifa është kollaj të ngecësh. Ky është thelbi pse këto dy rrjete i menaxhon operatori publik, si në asnjë vend tjetër. Në vendet e tjera, që janë shumë më të konsoliduara, nuk është kaq me rrezik sa në Shqipëri. Këtu kanë pasur frikë dhe u mendua kjo zgjidhje. Pra, një rrjet është i operatorit lokal, si logjikë.

Edmond Isaku – Po të shohësh edhe nga diskutimi shumë i shpejtë që u bë, në pamje të parë RTSH-ja duket sikur është në hallin e vetë dhe ne po i biem në qafë. Në fakt, po i biem në qafë, se jemi i vetmi vend ku dy frekuenca i jepen RTSH-së, pa lidhje fare, dhe u hiqet e drejta televizioneve lokale për të pasur një frekuencë që e përcakton ligji.

Hiqjani një rëndësi frekuencë televizionit shtetëror, jepuani televizioneve lokale dhe ne nuk i lutemi më atij. Edhe ai ka të drejtë të thotë: unë kam këtë nivel, do të hysh, paguaj kaq lekë. Na lini në punën tonë! Na jepni frekuencën tonë dhe nuk do të kemi debat, ligji e përcakton, se po bëni kthim mbrapa. Atë që po bëni me TVSH-në e ka bërë “Top-Channel” para 15 vjetësh. Sikur keni bërë të dy një arritje jashtëzakonisht të madhe dhe me atë reklamën e kanoçeve ju ka dalë RTSH-ja... pa pikë lidhje sot në vitin 2018!

Zotërinj, hiqjani RTSH-së, në qoftë se nuk keni frekuencë tjetër dhe jepuani televizioneve lokale dhe asaj mos i bini në qafë, le të vazhdojë punën e vetë, edhe neve mos na bini në qafë! Jemi gjithë këto institucione të mbledhura bashkë dhe nuk po ndajmë një gjë që e kemi në dorë! Ç’do të thotë kjo? Të japësh dy frekuenca dhe i thua asaj: kjo është e televizioneve lokale, por menaxhoje ti! Pse ne të tjerët çfarë jemi? Jemi pa logjikë dhe pa organizim ne?! Pse i bini më qafë asaj? Lëreni në punën e vetë! Digjital tokësor do të bëhet RTSH-ja? Kjo nuk ka kuptim. Ke dy platforma, ne jemi konkurrentë, por nuk mund ta transformosh tjetrin me gjithë atë investim që ka bërë! Janë dy platforma në treg që transmetojnë, dhe çfarë kontenti do të?... Hiqeni një rëndësi frekuencë! Nuk ka arsye ta mbajë me gjithë ato shpenzime, kur vjen platforma në treg dhe të gjitha televizionet lokale janë në treg. Sistemojeni këtë gjë, është e thjeshtë fare! S’kemi pse të bëjmë debat për një gjë që e ke dhe duhet thjesht ta ndajmë! Edhe këtë s’e bëjmë dot ne?

Albana Vokshi – Zotëria e kërkoi fjalën...

(Diskutime pa mikrofon.)

Lutfi Meçka - Unë jam Lutfi Meçka, nga televizioni i Kukësit.

Unë operoj në tregun e televizionit prej 21 vjetësh dhe kam hyrë në vitin e 22-të. Në qershor kam mbushur 21 vjet në treg, në kohën më të vështirë të çështjes kombëtare. Në atë kohë ekzistonin vetëm dy televizione lokale, Alba TV dhe TV Shijaku.

Në vitin 1999 kam marrë sinjalin në Tiranë, në një kohë të vështirë për kombin. Kam kaluar shumë peripeci gjatë kohës kur kërkova që antenat e televizionit të vendoseshin në fshatin Midhë në Pukë, pasi RTSH-ja më kërkoi 3 milionë lekë në muaj, në vend që të më thoshte: “Mund ta vendosësh pa lekë transmetuesin në fshatin Midhë të Pukës, vetëm na sill informacione”, pra pa më kërkuar 3 milionë lekë. Me leje të Presidentit të asaj kohe u vendos të më lihej shuma 1,5 milionë lekë.

Gjatë gjithë kësaj kohe kam kaluar shumë peripeci, sepse ma kanë prerë disa herë sinjalin, në mënyrë që të mos vinte sinjali në Tiranë, për shkak të konkurrencës, pasi u hapën televizione

të tjera, si: Top Channel, televizioni Klan e të tjerë. Unë i kam të regjistruara të gjitha problematikat e çështjes kombëtare të Kosovës në atë kohë.

Problematika që kam është se që në vitin 2006 kam kërkuar frekuencë për transmetimet digjitale dhe menjëherë kam marrë përgjigjen: “Nëse do të dilni në transmetime digjitale, atëherë do të paguani 40 milionë lekë gjobë”, në një kohë kur të tjerët ishin duke transmetuar pa licencë. Unë e kam letrën, ku vërtetohet se do të paguaja 40 milionë lekë gjobë, nëse do të dilja në transmetim.

Aktualisht, që nga viti 2000 transmetoj me rreth 9 frekuenca, të cilat i paguaj rregullisht. Unë paguaj 10 milionë e 580 mijë lekë, 5 milionë lekë nga të cilat i paguaj për licencën dhe 5 milionë e 580 mijë lekë i paguaj për frekuencat.

Kanë kaluar 21 vjet dhe mua sot më heqin nga tregu, në një kohë kur unë e kam licencën rajonale për zonën e Kukësit, Hasit, Tropojës, për prefekturën e Lezhës, prefekturën e Durrësit dhe të Tiranës. Atëherë, si mund të më heqin mua nga tregu, ku prej 21 vjetësh kam pagur rreth 9 frekuenca? 54 i kam paguar në Dajt, 56 i kam paguar në Ishëm, 53 i kam paguar në Rrëshen, 48 i kam paguar në Midhë të Pukës, 31 në Kukës, 50 në Qafë-Prush dhe 43 në Pogaj për çështjen e Kosovës.

Si mund të mos më jepet mua frekuencë, kur ligji e përcakton se duhet ta marrë ai që ka licencë rajonale?!

Pse televizionet lokale, që përfshijnë zonën e Tiranës dhe zonën e Jugut, marrin frekuencë? Edhe ne të tjerët, aty ku jemi, duam të marrim frekuencë dhe pastaj me këtë frekuencë të bashkohemi të gjithë.

Pse gjithmonë duhet t’i përgjigjem unë RTSH-së, e cila ma ka marrë shpirtin gjithë kohës, sepse më ka prerë sinjalin në kohën më të vështirë? Unë kam paguar 21 milionë lekë gjobë vetëm se më kishte rënë antena dhe kur ia kam thënë këtë gjë më ka çuar në gjyq dhe kam paguar faturat.

Unë kam shpenzuar 500 milionë lekë mall dhe ti m’i shkel. Nëse prishet një kioskë, e kompensoni, kurse neve nuk na kompensoni. Hiqeni kompensimin, sepse unë kërkoj frekuencat. Unë kam 4 prefektura dhe për këto prefektura kërkoj të kem licencë.

Reklamat shtetërore.

Neve asnjëherë nuk na kanë ardhur reklamat shtetërore. Edhe KQZ-ja reklamat i ka çuar atje dhe janë firmosur miliona lekë për këto reklama. Ju të Komisionit të Medies, të majtë dhe të djathtë, kontrollojini se ku kanë shkuar reklamat shtetërore, sepse bëhet fjalë për miliona lekë.

Nga mbledhjet që kemi bërë na ka rezultuar se për reklamat shtetërore janë paguar 14 milionë euro dhe ne nuk kemi marrë asgjë, ose mund të kemi marrë vetëm 300 mijë lekë, sepse këto lekë u jepen agjencive dhe ato na thonë se kanë firmosur dhe kanë marrë kaq lekë.

Unë kam bërë kontratën me RTSH-në, sepse AMA më ka çuar disa herë shkresa. Nuk më ka zënë gjumi duke menduar nëse duhet të lidhja apo jo kontratë, sepse prej 21 vjetësh unë paguaj 2160 euro pa TVSH për transmetimet në Tiranë. Po të marrim edhe Lezhën, ku paguaj 900 euro, më bie të paguaj rreth 4 mijë euro në muaj. Ku t'i gjej unë 4 mijë euro në muaj, sepse i bie 5 apo 6 milionë lekë në muaj? Si mund të qëndroj unë në treg, kur unë vetë vij nga Kukësi në Tiranë?

Në rregull! A doni ta bëjmë kështu? Unë transmetoj në 4 prefektura dhe nëse ti i merr popullit 1 mijë lekë TVSH dhe ke 20 kanale, unë kërkoj të më japësh 5 lekë që të lejoj të shikosh kanalin tim. Pra, me aq sa popullsi ti ke, atë 5 lekësh ma jep mua, dhe bëhet fjalë për 50 lekë të vjetër. Është e njëjta situatë si me KESH-in, sepse kam 8 sahate, për të cilat jap 9 mijë lekë çdo muaj, kurse për frekuencat jemi të gjithë dakord.

Milva Ekonomi – Kush mund të më thotë një problem tjetër?

Aristotel Petro – Përshëndetje!

Unë quhem Aristotel Petro dhe jam pronari i Radiotelevizionit Alpo në Gjirokastrë. Unë përfaqësoj mediet lokale në qarkun e Gjirokastrës dhe dua të shpreh shqetësimin tim në lidhje me problematikat që kemi jo vetëm në medien time lokale, por me të gjitha mediet lokale në përgjithësi. Të gjithë e dimë rëndësinë e një medieje lokale, prandaj është e domosdoshme të reflektojmë dhe të reagojmë ndaj këtyre problemeve dhe jo thjesht t'i dëgjojmë dhe t'i anashkalojmë.

Unë dua të bëj një replikë në lidhje me atë çfarë tha zoti Henri Muça, për sa i përket përfaqësimit të RTSH-së dhe rregullave që RTSH-ja po aplikon ndaj nesh.

Problematika nuk qëndron vetëm te çmimi i abonimit që ne duhet të paguajmë, por në aspekte të tjera ato janë më të mëdha. Për shembull, në Gjirokastrë RTSH-ja ka dalë me një filial tjetër, televizioni Gjirokastra, i cili po na konkurren drejtpërdrejt duke marrë reklama, me shkëmbime apo me çmime prej 10 mijë lekësh të rinj dhe më poshtë.

Ne nuk jemi një lavatriçe larëse lekësh, por jemi televizione që mbahemi vetëm me reklama. Kështu, nëse nuk marrim reklamat, të paktën me një vlerë 20-25 mijë lekë ose 30 mijë lekë në muaj, ne nuk mund të mbijetojmë dot. Në kushtet kur neve na konkurren drejtpërsëdrejti RTSH-ja me çmime tejet të ulëta, atëherë ne nuk mund të funksionojmë dot. Ky është një problem

i madh pasi RTSH-ja ka rreth 30 punonjës, të cilët i paguan me një buxhet prej 50 milionë lekësh në muaj dhe nuk mund të marrë një reklamë me 100 mijë lekë të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ideja nuk është që ta bëjë falas...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë e kisha për replikë, sepse nuk dua që të përmenden kostot e fryra, që i përmendi zoti Muça...

Albana Vokshi – Le t’i lemë replikat dhe të dalim te problematika juaj konkrete dhe si mund t’i japim zgjidhje për aq sa mundemi sot, këtu. Pra, nëse do të shtyhet afati nga 31 korriku, të paktën të lëmë 3-4 muaj, që ne, si komision, por edhe komisionet e tjera, t’i trajtojmë edhe njëherë këto problematika.

Ju lutem, flisni vetëm për problematikat më shqetësuese!

Aristotel Petro – Unë mendoj se jo vetëm që duhet shtyrë afati i mbylljes së transmetimeve digjitale-analoge, por duhet lënë një periudhë *greis*, e cila mund jetë edhe analoge, edhe digjitale, derisa njerëzit të mësohen dhe transmetimi t’iu kalojë dalëngadalë.

Mediet duhet të kenë frekuencën e tyre të pavarur, që do të thotë se nuk duhet të jenë të varura as nga RTSH-ja, as nga ndonjë medie tjetër private.

Unë dhe përfaqësuesit e medieve të tjera lokale mendojmë se mediet e mëdha po na bëjnë bllokadë dhe po na konkurrojnë në mënyrë të pandershme, qoftë nëpërmjet posteve që kanë zënë në RTSH apo edhe në drejtime të tjera.

Doja të theksoja edhe një gjë tjetër. Medieve vazhdimisht po u caktohen taksa dhe pagesa. Po u nxjerrin detyrime pa fund të gjitha medieve lokale, detyrime të cilat vetëm sa shtojnë kostot dhe vështirësojnë punën tonë. Një nga këto detyrime është edhe pagesa për të drejtat e autorit, e cila duhet të jetë, por jo në atë masë dhe në atë lloj forme, pasi edhe ne, si medie, në fund të fundit, jemi emetues dhe kemi të drejtën tonë të paguhemi për ata që na shikojnë. Ne jemi emetues, por ne nuk na njohin si emetues dhe nuk na shpërblejnë për transmetimet dhe punën që bëjmë. Pra, ne kërkojmë nga shteti të njihen, ashtu siç njihet RTSH-ja, edhe mediet lokale si emetuese. Nuk kërkojmë të jemi të barabartë me RTSH-në, por të suportohemi në njëfarë mënyre, në njëfarë mase, pasi mediet lokale janë në rrezik potencial për mbyllje, për zhdukje nga qarkullimi.

Dikur ne kemi pasur shumë gazetarë. Tani jemi katandisur me 2-3 persona nëpër medie, gjë që tregon asfiksimin tonë, një tkurrje shumë e madhe, si pasojë e mosarritjes së mbledhjes të të ardhurave.

Këto të ardhura nuk na janë ndërprerë rastësisht, por mendojmë se janë të organizuara. Tkurrjet dhe mbylljet tona janë të qëllimshme, pasi nëse e shikojmë pak me vëmendje, edhe institucionet shtetërore po na bëjnë presione drejtpërdrejt. Për shembull, unë kam pasur disa raste në Gjirokastrë, ku drejtori i AKU-së në Gjirokastrë u ka vënë gjobë disa subjekteve vetëm se kanë sjellë reklamat e tyre te media jonë dhe i ka thënë: “Ç’tu desh ty, që dole aty në media?” dhe i ka dërguar direkt gjobën prej 1 milionë lekësh. Raste të tilla ka pasur dhe këto janë presione të drejtpërdrejta edhe nga institucionet shtetërore.

Në qoftë se ne pretendojmë të futemi në Bashkimin Europian me të drejta të barabarta për të gjithë, le të ketë edhe për mediet lokale një të drejtë të barabartë. Të jemi edhe ne të barabartë me të gjithë dhe të mos diskriminohemi.

Ne e ndiejmë vetën tepër të diskriminuar, në shumë aspekte. Ne kemi 20 vjet që operojmë në treg, po shpenzojmë energjitë tona dhe po harxhojmë kohë nga jeta jonë. Përfitimet që duhet të kishim po i hedhim të gjitha për ta mbajtur medien me thonj dhe nuk duhet të diskriminohemi dhe të jemi të disfavorizuar për sa i përket problemeve që po na nxjerrin artificialisht.

Të gjitha problemet, që i thanë edhe kolegët, qëndrojnë dhe nuk dua t’i përsëris, pasi dua t’ia jap fjalën edhe kolegëve të tjerë.

Duke e mbyllur fjalën, nga ju, zonja Albana dhe zonja Milva, shpresoj të na merren parasysh kërkesat.

Ju faleminderit!

Arqile Gorea – Përshëndetje!

Arqile Gorea, administrator i televizionit Adria.

E para, ju falënderoj shumë për kohën që na kushtuat dhe për dëgjuesën që i bëtë sirenës së alarmit!

Me të vërtetë, situata për mediet lokale është jo alarmante, por përtej alarmantes.

Pavarësisht nga situata dhe mënyra si paraqitet dhe propagandohet, unë po jua them shqip: media po vritet me silenciator. Pavarësisht se ç’thuhet, që janë bërë takime, askurrkush nuk është në gjendje të thotë se çfarë kanë mbetur nga këto takime.

Që në 2013-n, kur diskutohej ligji nr. 97 i vitit 2013, televizionet lokale duhet të kishin frekuencat e veta. S'ka ndodhur. Në çdo takim është ngritur si kërkesë. Kjo është një eksperiencë speciale shqiptare, sepse komshinjtë tanë kanë frekuencat e veta.

Secili nga ne ose një grup nga ne mund të jetë në gjendje ta ngrejë platformën dhe nuk ka pse të futemi ndërmjet RTSH-së, AMA-s dhe cilitdo tjetër. Secili mban përgjegjësitë e veta, sipas aftësive, sipas mundësive që ka. Kjo është drejtpërdrejt heqje e të drejtës së mbijetesë. Pra, që këtu fillon prishja e konkurrencës.

E dyta, në takimet që ne kemi bërë edhe me përfaqësues të Komisionit European dhe të Komunitetit European, kemi drejtuar pyetjen: “Televizionet lokale në vendin tuaj (ishte ai spanjoli, nëse të kujtohet), a kanë frekuenca?” “Po, kanë.”

Pra, pse rendim me shpejtësi për krijimin e një atmosfere mbytëse për median lokale?

Të nderuar politikanë dhe ju të tjerët që na dëgjoni,

Media është habitat i më i çmuar i demokracisë.

Mos harroni, për pak kohë troket një fushatë tjetër. Do të shkoni nëpër qytete, por nuk do të gjeni medie. Do të gjeni vetëm media që kanë politikën e tyre editoriale dhe transmetojmë sipas pagesave që marrin. Pra, ne po u heqim medieve parfumin e qytetarit, parfumin e halleve dhe problemeve që kanë njerëzit. Kjo vjen pikërisht nga këto mediet e vogla, që ngelën të vogla, sepse nuk pranuan të bëhen shërbëtore, se po të ishin bërë shërbëtore, shumë shpejt do të ishin rritur. Nuk është nevoja të na tregojë njeri këtu historikun e medieve dhe aftësitë e gjithsecilit !

Nëse keni durim, po ju tregoj se kur Zoti ndau vendet e shpendëve dhe të kafshëve në tokë, shqiponjësi i caktoi majën e malit. Shqiponja fluturoi, hipi në pozicionin e vet dhe u lumturua. Dëgjoi një zhurmë të vogël: krrëk-krrëk. Ishte kërmilli. I tha: “Po ti, ç’do këtu?” “Këtu e kam vendin edhe unë”, tha kërmilli. “Po si arrite?” “Duke u lëpirë”.

Pikërisht, këto medie kanë mbetur të vogla, sepse nuk janë lëpirë. Nuk është defekt, por është krim që i bëhet fjalës së lirë, t’u krijosh medieve lokale ambient mbytës.

Unë nuk do të nisem nga reklamat, sepse ajo është një pjesë shumë e vogël, që ka të bëjë me të gjithë sistemin demokratik në vendin tonë.

Po nisemi nga ligjet. Ligji nr. 97/2013, pse nuk është zbatuar? Akoma sot nuk e përmendim. Themi: “Kemi bërë takime, kemi lexuar gazetatat, kemi bërë informacion politik.” Jo, jo, ne duam zgjidhjen e problemeve.

Kemi ligjin tjetër, për pagesën, nr. 34/2017. “Pagesa për një vit do të bëhet nga shteti.” Tani janë shpikur disa formula me akrobaci: pagesën do ta bëjnë mediet vetë, pastaj faturën do ta paraqesin tek AMA, si garante e medieve lokale dhe AMA më pas do t’i bëjë kompensimin.

Faktikisht, nga eksperiencia, jemi një shtet me shumë vështirësi daljeje. Edhe gjërat që janë të institucionalizuara, siç është TVSH-ja, mezi merren, jo më ato para që paguhen në medie. Kjo është shumë e dhimbshme.

“Hajde ti dhe m’i paguaj paratë, se do të t’i japë shteti.” Jo, ti më ke dal për zot mua. Ke thënë: “1 vit (e ke me ligj) do të ta paguaj unë.”

Pse duhet ta kapim veshin mbrapsht?

Askurrkush nuk kujtohet për këto.

Më vjen keq, zoti Sala është njeriu që përfaqëson median, por përfaqëson median vetëm me detyrën që t’i kërkojë llogari asaj. Të mos harrojmë për asnjë çast se në atë karrige ku është, siç ka të drejta, ka edhe detyrime. Ka detyrimin e madh, jo për të na marrë taksat, por për të na mbrojtur në këtë situatën ku ndodhemi tani, që kërkon ta kalojmë kështu...

Unë nuk dua të flas më gjatë, se të gjithë e njohim njëri-tjetrin dhe i kuptojmë se si ndodhin gjërat.

Zonja dhe zotërinj,

Ndodhemi para një situatë, që për mua është tepër alarmante. Është alarmante për të gjithë, nuk po përmend krahët, të majtë të djathtë apo të qendrës.

Të gjithë jemi njerëz dhe Zoti na ka dhënë gojë. Goja e shoqërisë është media.

Mendoni, zonja dhe zotërinj, të shihni një natë ëndërr sikur doni të flisni dhe nuk flisni dot. Do të çoheni të lemerisur nga gjumi. Kjo do të ndodhë në vendin tonë mbas disa kohësh. Është detyrë e të gjithëve ne, që të mos turpërohemi nesër, që marrim pjesë nëpër mbledhje të tilla dhe nuk flasim, që i lëmë të na gënjejnë dhe nuk kundërshtojmë, që i lëmë të na tregojnë përralla dhe tregohemi të mitur.

Unë nuk kam asgjë me pjesën... RTSH-ja ka të drejtën e saj të ekzistencës dhe zhvillimit, ashtu si të gjitha televizionet e tjera, por edhe ne kemi të drejtën tonë. E drejta jonë është ajo që është me ligj që në 2013-n.

Më jep, o vëlla, frekuencën!

Unë jam i vetmi televizion lokal në Durrës. Përse të mos kem frekuencë? Siç e ka Luti në Kukës apo Mondri në... Ose na jep mundësinë të bëhemi një grup, të marrim një frekuencë.

Të drejtat na futen në gërrshërë, kurse detyrimet na mëshojnë në kurriz, mundësisht edhe me këpucë me gjemba. Kjo nuk shkon.

Kemi edhe një problem tjetër, që ulëret. Ne i kemi sytë në ballë. I dëgjojmë lajmet po nga këto media. Prishet një barakë, se bie një plan rrugë, dhe kompensohet. Të mos flasim pastaj kur prishen pallate dhe apartamente, që merren paratë kokërr më kokërr. Tani, prishet gjithë ky investim, gjithë kjo teknologji, e bërë me mund e me djersë, ka nevojë për një lloj kompensimi... Të mos i hyjmë detajeve se si janë ndarë, se nuk dua ta zgjas dhe të ha kohën...

Këtu ka pasur dy lloj tavolinash: tavolina interesi, që kanë qenë me pak përfaqësues, ku nuk ka qenë asnjë nga ne, si dhe tavolina publicitare, ku na kanë thirrur ne për të na përdorur si fasadë. Jo, zotëri, ky është afati i fundit, ku ne duhet t'ju themi të gjithëve: “Ne jemi media dhe nuk pranojmë të përdoremi si fasadë”

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për kompensimin. Televizionet janë i vetmi subjekt që paguan licencën çdo vit. Pse duhet ta paguajnë televizionet licencën çdo vit? Licencën çdo vit, reklama shtetërore jo, luftë politike, siç thotë Teli, “në qoftë se ti e çon reklamën te filan subjekt, unë të heq dhe çojë atje” dhe receptura të shëmtuar të kësaj natyre...

Mendoj së kjo tavolinë duhet të dalë në një konkluzion dhe konkluzioni duhet të jetë ky: të ulemi, zotërinj përfaqësues të qytetarëve, që ju kanë çuar në parlament. Ndoshta ka ardhur kohë për të ndërmarrë edhe një iniciativë ligjore, aq më tepër që kemi edhe ligje, që duhet t'i zbatojmë. Kemi ligjin e 2013-s dhe 2017-s, ligjin nr. 97 dhe ligjin nr. 34, që s'po zbatohen dhe...

Këtu flitet që nuk zbatohet ligji. Ty, me gabimin më të vogël, kam të drejtë të të gjobis. Po për zbatimin e ligjit që të përfaqësosh të drejtat e mia, çfarë thua ti dhe çfarë bën?

Dua t'i lë radhë të gjithëve të flasin, por vetëm një gjë po ju them: situata për mediet lokale është shumë alarmante, është mbytëse.

Mos harroni, qeliza e demokracisë dhe e medias së lirë është media lokale, sepse këtu lind mendimi i lirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Më falni!

Ju lutem, të mos e bëni kakofoni! Gjithsecili...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër! Po ju lëmë gjithë kohën të trajtoni shqetësimet. Siç e shikoni, ne nuk po flasim. Asnjë nga deputetët nuk ka folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka Vlora. Do t'ia jap edhe Fierit.

Ju lutem, shumë shkurt, problematikat që hasni! A keni propozime konkrete, që mund t'i ndërmarrim sot? Domethënë, të kalojmë në diçka konkrete, që sot të dalim me një përfundim.

Albert Delia – Unë jam Albert Delia. Vij nga televizioni “6+1 Vlora”.

Zonja Kryetare, unë nuk do të them ndonjë gjë të re. Do të them ato që janë thënë.

Është e vërtetë, siç e tha edhe zoti kryetar, janë bërë shumë takime, por ne nuk kemi qenë asnjëherë dakord me tarifën e vendosur nga RTSH-ja. Kjo nuk është thënë dhe duhet të thuhet.

Kisha problemin e tarifës së RTSH-së dhe problemin e reklamës shtetërore.

Reklama shtetërore duhet të ndahet në mënyre të barabartë. Përveç televizioneve kombëtare, reklama duhet të marrin edhe televizionet lokale.

Në Vlorë kanë qenë disa televizione, një pjesë e tyre janë mbyllur për arsye nga më të ndryshmet, përfshirë problemet ekonomike dhe të tjera. Të gjithë, përfshirë edhe mua që jam sot këtu, jemi në vështirësi ekonomike. Punojmë çdo ditë, nga e hëna në të hënë, dhe mezi ia dalim, jo më të paguajmë gjithë atë tarifë të RTSH-së. Është e pamundur. Më mirë të na thoni t'i mbyllim televizionet, është më e ndershme sesa të paguajmë 1500 euro. Është e pamundur të paguash 1500 euro për RTSH-në.

Këto kisha.

Faleminderit!

Unë kërkoj që, maksimumi, të ulet në masën 50% tarifa e RTSH-së.

Albana Vokshi – Sa?

Albert Delia – 50%

Po të shikosh edhe shpenzimet që ka kryer RTSH-ja (siç thonë, se unë vetë nuk e kam parë), që një roje të paguhet 700 euro... 700 euro nuk marrin...

(Diskutime pa mikrofon.)

Artur Rustemi – Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Artur Rustemi, president i televizionit Apolon në qytetin e Fierit.

Ju dhe të gjithë faktorët që janë mbledhur për digjitalizimin: Komisioni Medies, kryetari i AMA-s dhe drejtuesit e RTSH-së, të na mirëkuptoni, se çdo gjë bëhet për të mirën e kësaj... Kemi

më shumë se 5 vjet që kemi filluar me digjitalizimin, kanë ardhur edhe nga bota, nga OSBE-ja, për të na kanë sqaruar dhe prisnim të... Në qoftë se në një qytet kishim zënë 6 televizione, 6 frekuenca, me digjitalizimin, me këto 6 frekuencat, do të ishin 60 kanale. Në vend të liroheshin, të liberalizoheshin, këto u shtrënguan më tepër. Këtu nuk e kuptoj. Ku është...?

Nuk e di nëse më dëgjuat, zonja kryetare. Më parë televizionet kanë qenë analoge, çdo televizion kishte një frekuencë. Në një qytet ishin 5-6 televizione dhe 6 televizione kishin zënë 6 frekuenca dhe me digjitalizimin e këtyre 6 frekuencave marrin 60 televizione dhe në këto raste do të liberalizoheshin, kjo nuk do të ishte problem fare për ne, por çdo qytetar dhe çdo gazetar i Shqipërisë mund të hapte një televizion. Nuk e kuptoj ku është shtrëngimi këtu, pra ka diçka që nuk shikon dhe kjo ishte sa për fillim. Unë po u bëj një pyetje përfaqësuesve të AMA-s, nuk e di nëse jam drejtpërsëdrejti dhe çmimet e këtyre i ka vënë AMA apo RTSH-ja, nuk e di se cili prej tyre do ta marrë përsipër, ku janë bazuar ata që Fierit ia vënë 2 mijë euro, ndërsa Tirana dhe Durrësi së bashku 2600 euro ose Vlorës 1500 euro. Ku janë bazuar ata, a ka investime më të mëdha Fieri?

Unë mendoj se televizionet lokale apo AMA duhej t'i kishin ndihmuar njerëzit nga ana ligjore, sepse vetëm thuhet se mund të bëhen bashkë, por t'u jepen garantëve dhe të paraqiten njerëzit për të marrë frekuencën dhe më pas t'i caktojë AMA një frekuencë Fierit, Durrësit apo Elbasanit dhe kjo punë mbyllet.

Po ashtu kisha një pyetje për përfaqësuesit e RTSH-së. Qytetarët e Fierit, kjo është shumë e rëndësishme sepse qytetarëve u shërbejmë, janë shumë të shpërndarë. Çfarë është RTSH-ja, sa kanale do të transmetojë gjithsej? E gjithë paketa do të jetë me lekë apo vetëm stacionet kombëtare do të jenë pa lekë?

Po ju flas për vete dhe për investimet që kam bërë. Pra, pas thirrjes që u bë nga qeveria dhe nga AMA për kalimin e frekuencave dixhitale, i jam përgjigjur thirrjes së digjitalizimit dhe kam bërë të gjitha investimet full HD, por në momentin që kërkoj ta dërgoj sinjalin te RTSH-ja, kjo e fundit më thotë se duhet të ma sjellësh sinjalin SD. Atëherë, pse unë duhet të kthehem mbrapa dhe të më prishet sinjali? Këtë nuk po arrij ta kuptoj dhe më duket sikur qëndron ajo që tha kryetari i shoqatës se tregu nuk çuditet se e ka bërë që para 20 vjetësh përfaqësuesi i TOP-it, apo kush e ka bërë.

Ne ndoshta kemi shumë gjëra për të thënë, flasim dhe disa prej tyre nuk arrijmë t'i kuptojmë dhe e zgjasim pak si shumë, por nuk është faji ynë, sepse ka diçka që nuk shkon dhe problemet nuk mbarojnë.

Më falni, dua t'ju them diçka interesante. Unë kam 2 muaj që realizoj transmetime dixhitale dhe AMA më ka thënë ta mbyll se ndryshe do të më gjobisë. Nuk arrij ta kuptoj këtë gjë, sepse frekuenca që unë kam, po të ishte në transmetim, çfarë të keqe do të kishte? Ajo do t'u shërbente qytetarëve, apo atyre njerëzve që janë pa bukë në shtëpi. Kur unë u kam thënë se do ta shohin te RTSH-ja, ata më kanë thënë: "Na latë qorr tani, se nuk kemi lekë ta blejmë". Ndërsa unë u thashë të blinin dekoderat 30 mijë lekë apo aq sa kushtonin...

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ju lutem, a mund të më thoni se kush do të flasë tjetër, ta di?

Po ju dëgjojmë ju deri në fund, më pas t'ju përgjigjemi pyetjeve që keni bërë dhe në fund të kalojmë, nëse kanë deputetët ndonjë gjë për të shtuar, të kalojmë në disa propozime konkrete, të cilat unë së bashku me zonjën Ekonomi u munduam t'i diskutojmë sadopak.

Fejzo Subashi – Faleminderit!

Unë quhem Fejzo Subashi, përfaqësues i BBF televizion.

Problemet janë pak a shumë të njëjta me ato që thanë edhe parafolësit. Unë propozoj shtyrjen e afatit të digjitalizimit për një kohë sa më të gjatë, për t'u dhënë mundësinë edhe këtyre të ambientohen me këtë sistem, për arsye se, po jua them sinjerisht, ka një kosto. Po të marrim një televizion të vogël, gjë që e kam thënë me mijëra herë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Të lutem, ta mbaroj fjalën!

.. kostoja e qirasë ndaj TVSH-së është sa kapitali i një televizioni lokal, vetëm qiraja, pa llogaritur të tjerat. Unë jam dakord dhe i qëndroj faktit që frekuenca t'u jepet televizioneve lokale, sipas ligjit dhe duke e zbatuar atë, ose në të kundërt shoh si të arsyeshme përmirësimin e ligjit. Pra, një ligj, i cili sjell probleme do të thotë se nuk është i mirë dhe kjo kërkon si të domosdoshme përmirësimin e ligjit dhe jemi me fat që jemi me ligjvënësit. Pra, duhet një ligj që AMA të ketë më shumë fuqi dhe jo vetëm një AMA që kërkon vetëm llogari, por të na mbështesë dhe të ketë fuqi të plotë, siç është në të gjitha vendet e botës, një ent rregullator, duke rregulluar raportet midis njëri-tjetrit edhe me shtetin, gjë të cilën nuk e kemi dhe AMA për këtë gjë është krijuar në botë.

Çështja tjetër që unë propozoj ka të bëjë me kompensimin e teknologjisë. Siç e tha edhe zotëria, mos u çudisni kur unë si përfaqësues i një televizioni xhiroj te 8K, pra aparaturat e mia xhirojnë drejt 8K, nga 6 deri në 8K dhe jo me nga 4K. Pra, po vijmë pajisje nga Italia, nga Belgjika

dhe shumë vende të tjera të botës, të cilat nuk i kanë këto që unë po xhiroj, produktet dhe materialet artistike që nxjerr BBF-ja janë drejt 8K.

Gjithashtu, ne si televizion transmetojmë drejt rrjeteve sociale me ultra HD dhe tani më duhet ta dërgoj drejt TVSH-së, ashtu siç tha ai, jo me HD, por poshtë HD-së, dua ta shtrydh. Pra, vetëm kostoja kërkon që të marr fibra direkt dhe t'i dërgoj nga televizioni im direkt te TVSH-ja, por kam 2 muaj dhe nuk po arrij ta ndërtoj dot, pasi dua cilësi dhe kërkoj t'u jap qytetarëve produktet ashtu siç duhet. Ne menaxhojmë artistë, punojmë me artistë dhe teksa është duke u bërë luftë për një teatër po punësojmë me qindra dhe dhjetëra artistë, prandaj televizioni nuk duhet parë thjesht si një produkt për lajm, por duhet parë si produkt artistik, ky është qëllimi dhe misioni i AMA-s.

Hidhet poshtë një teknologji që kushton miliona euro! Prandaj unë propozoj që të ngrihet një komision dhe të vlerësojë se sa është kostoja e subjekteve medietike, sa e kam unë si televizion koston, sa e ka televizioni tjetër dhe jo të thuhet se kaq e pashë të arsyeshme dhe kaq dhashë, pavarësisht se dhënia e investimeve mund të ndodhë pas 5 vjetësh ose kur të jetë mundësia.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka zotëria dhe më pas do të vazhdojmë me përgjigjet.

TV Lezha – Përsëritet të gjithëve!

Jam pronar i televizionit të Lezhës për dy qarqet Lezhë dhe Shkodër. Kam 22 vjet që menaxhoj dhe drejtoj televizionin. Kemi kaluar peripeci dhe presione nga më të ndryshmet, deri edhe deputetë të parlamentit shqiptar kanë arritur të deklarojnë: “O vdesim, o ta mbyllim televizionin”. Sot, të na mohohet e drejta për të pasur ato frekuenca, mua më duket shumë e padrejtë!

Është më e ndershme të na thuhet: “Do të kthehemi në sistemin që ishte para 28 vjetësh” sesa të menaxhohen vetëm 2-3 televizione që do qeveria, që shpresoj se kjo nuk do të ndodhë, dhe të na mohohet mudi dhe puna jonë 22-vjeçare.

Nuk dua të përsëris fjalët e kolegëve të mi, por dua t'ju bëj një apel: vendosuni në pozitën tonë dhe kuptoni se sa kemi vuajtur për t'i mbajtur në këmbë prej 22 vitesh këto media.

Shpresoj që takimi i sotëm të mbyllet me një konkluzion të saktë lidhur me interesat tona.

Faleminderit!

Albana Vokashi – Faleminderit!

Po ia kaloj fjalën, zotit Sala. U bënë disa pyetje, do t'ju lutesha t'u përgjigjeni.

(Diskutim pa mikrofon.)

TV Lezha - Më falni për ndërhyrjen, por zotëria në krahë më kujtoi diçka: “Erdhën për të më intervistuar lidhur me sinjalin e Televizionit Publik Shqiptar kur do të transmetohej Kampionati Botëror nga media publike në të gjithë territorin shqiptar. Me shumë edukatë u thashë: “Me shumë kënaqësi do t’ju jap intervistë, por pasi të ma nxirrni në transmetim Televizionin Publik në qytetin e Lezhës. Nga 45 mijë banorë që ka qyteti i Lezhës, do të fillojmë të kontrollojmë çdo hyrje, pallate e familje një për një dhe do të shikojmë se ku ka sinjal të TVSH-së. Në qoftë se vetëm në një familje shfaqet kjo media, unë si gazetar deklaroj se do t’jua fal “TV Lezhën” edhe pse kam 22 vjet që punoj për të.”. Në moment ata morën në telefon dhe thirrën inxhinierët e Televizionit Publik Shqiptar dhe ata me shumë edukatë i thanë – “Po, është e vërtetë! Pronari i “TV Lezha” ka shumë të drejtë, TVSH-ja nuk ka sinjal!”. Falë kompanisë “Tring”, që kishte kabllorin në Lezhë, u pa Kampionati Botëror nga qytetarët.

Kjo është gjendja aktuale e Televizionit publik. Ejani dhe verifikojeni që në qytet ky sinjal mungon. Kanë vënë antenat në kryqëzim kur del nga malet e Milotit; kanë vënë disa antena që përçojnë sinjalin dhe lidhin bregdetin me malet e Burrelit e Mirditës, kurse për mediat në majën e Pllajës nuk ka pasur asnjëherë antena.

Kam biseduar me një inxhinier për të çuar sinjalin në Pllajë, por as ai nuk dinte nga ta nxirrte, sepse nuk ka fibra, ura lidhëse. Pra, edhe këto kanë kosto që ne nuk dimë si do t'i përballojmë.

Faleminderit!

Albana Vokashi – Faleminderit!

Në fakt, edhe unë, edhe deputetë të tjerë të komisionit kemi marrë shqetësimin për mungesën e sinjalit të RTSH-së në disa qytete. Këtë çështje e kemi trajtuar edhe në komision, kur ka qenë prezent drejtori i RTSH-së dhe përsëri u bëj thirrje drejtuesve të RTSH-së që të shohin se ka një sërë rrethesh e qytetesh, sot që flasim, që nuk kanë sinjal.

Zakonisht topi hidhet sa nga njëri institucion në tjetrin, por ky nuk është justifikim. Nuk ka justifikim që sot në Republikën e Shqipërisë ka ende qytetarë që nuk mund të marrin sinjalin e RTSH-së.

Zoti Sala, fjala për ju për pyetjet që të janë drejtuar dhe, më pas, fjalën do t'ia kaloj përfaqësuesit të RTSH-së. Zoti Boçi, Luani dhe Kejdi kanë kërkuar fjalën.

Unë kam disa propozime konkrete për sot. Nëse do të kemi edhe miratimin tuaj, atëherë mendoj që të konkludojmë në 2-3 pika konkrete, të cilat mund t'i ndjekë secili nga institucionet.

Faleminderit!

Gentian Sala – Faleminderit, kryetare!

Do të mundohem pak a shumë t'i thjeshtoj komentet dhe do të merrem me thelbin e problemit. Problemi i ngritur nga “TV Alpo” dhe nga “TV Adria” i zotit Gorrea, që secili nga operatorët të ketë frekuencën e tij, besoj që është e pamundur.

(Diskutim pa mikrofon.)

Secili më vete është e pamundur me këtë teknologji që kemi, ndërsa të gjithë bashkë të keni një frekuencë është gjë tjetër. Grup operatorësh është tjetër, alokment i një zone është tjetër. Ka alokmente që janë të lira, por ka të tjera që nuk janë të lira, megjithatë, thelbi, për mendimin tim, është frekuenca e RTSH-së që është aty.

Mua nuk më duket shtrenjtë pagesa prej 365 eurosh në muaj e Kukësit! Shoh një gjë disproporcionale midis Fierit dhe Tiranë-Durrësit. Po, është e vërtetë, do ta gjykoj edhe me stafin, që Fieri është 1665 euro, ndërsa Tiranë-Durrës është 2100, kur dihet që kanë 1 milion banorë, ndërsa Fieri ka 200,000-300,000 banorë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Fejzo, ka qenë 5 mijë euro, ka shkuar 2 mijë e ca euro dhe do ta diskutojmë prapë.

(Diskutim pa mikrofon.)

Edhe unë mund të thosha: “Aty i gjeta tarifat dhe po i lë aty ku janë!”.

(Diskutim pa mikrofon.)

Albana Vokashi – Ju lutem, e ngritët problemin, le të dëgjojmë tani shpjegimin që do të japë zoti Sala. Më pas, do të kalojmë edhe te përgjigjet konkrete.

(Diskutim pa mikrofon.)

Shumë dakord! Ju lutem, a mund të marrim dy përgjigje, ju lutem, se nuk mund ta bëjmë kakofoni. Të marrim dy përgjigje dhe pastaj jua jap përsëri fjalën, nëse ka paqartësi.

Gentjan Sala – Thelbi qëndron përsëri tek tarifa, ka kërkesa për uljen e tarifës, 50% e të tjera; është miratuar ligji për digjital-dividentin; ka dalë frekuenca e DD/1 në shitje; AKEP-i në shtator mbyll garën, po themi aq sa zgjasin procedurat e fituesit e të tjera, por brenda vitit është e sigurt që disbusohen lekët dhe një pjesë, minimumi 10 muaj dhe maksimumi 1 vit, e operatorëve lokalë paguhen. Unë nuk dua t'ju provokoj, por përse nuk e lëmë një vit procesin, sepse fatura do

të paguhet nga fatura e AKEP-it? Mbas një viti ulemi dhe gjykojmë nëse ka vlerë kjo frekuencë apo jo. A vlejnë këto diskutime që po bëjmë, apo jo? Nëse ju bie rentabël, apo jo? Çdo rreth nuk ka të njëjtat probleme. Po të shkojmë në qytet në Fier, nuk gjen asnjë antenë lart. Përse? Sepse rrjeti kabllor është i jashtëzakonshëm. Edhe AMA ka vepruar keq, sepse ka dhënë vetëm autorizime dhe të gjithë janë me sistem kabllor. Problemet tuaja janë të ndryshme, ndryshojnë në Tiranë, në Fier dhe në qytete të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Fevzo, mos bëni komente me mua, sepse po flas për Fierin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem, nëse është përsëri e paqartë, do ta jap përsëri fjalën. Ju lutem, mos ndërprisni njëri-tjetrin.

Gentjan Sala – Ndryshojnë problematikat, Fieri ka 10 vjet me sistem kabllor, ka tjetër problematikë dhe nuk gjen dot një antenë lart në qytet. Kjo nuk ka lidhje me dekoderin. Sigurisht që ka familje të varfëra, por deri më sot janë shpërndarë mbi 80 mijë dekodera për familjet në nevojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për sa i përket problemit të kanaleve, në Fier kanë qenë 11 kanale pa pagesë, ndërsa sot janë 29 kanale. Nuk është e vërtetë ajo që thotë Arturi që kjo nuk ka sjell ndonjë avantazh. Edhe kanalet e RTSH-së dikujt i duken bosh dhe dikujt i duken plot, por kjo varet edhe nga shijet e gjithsecilit, por nuk mund të thuash që digjitalizimi nuk vlen. Pra në Korçë, Fier dhe Berat janë nga 30 kanale pa pagesë, ndërsa në Tiranë do të jenë 34. Pra nuk duhet thënë se nuk ia vlen procesi.

Për shtyrjen e afatit, në Tiranë jo paqëllim e kemi lënë në verë, sepse interesi për televizionin është më i ulët dhe qytetarët lëvizin në plazhe dhe krijohen më pak problematika, nuk krijohet ndërprerje e menjëhershme dhe rrëmujë në treg, prandaj mund të themi ta shtyjmë deri në shtator ose për Vit të Ri. Të mos harrojmë që televizionet e mëdha, por edhe televizionet lokale i fillojnë programet e reja në shtator dhe nuk mund t’u thuash atyre që në mes shtatorit do t’ua heqim sinjalin dhe të krijojmë probleme, prandaj mendoj ta shtyjmë një muaj ose ta lëmë për në dhjetor. Gjithashtu, edhe platformat e mëdha si “Tring” dhe “Digjitalb”, janë duke bërë reklamë për shitjen e dekoderave, pra janë edhe ca të tjerë që nuk janë këtu, por edhe ata kanë rëndësinë e vet. Pra, mund ta shtyjmë një muaj sa të fillojë edhe parlamenti dhe në fillim të shtatorit e diskutojmë përsëri dhe mbase u futemi edhe më thellë problemeve të operatorëve.

Kalimi i sinjalit nga HD në SD është e vërtetë që është problem, por këtu është përcaktuar nga strategjia e 2012-ës dhe ne e kemi gjetur të gatshme. Mendimi im është që të marrim pikat që dolën këtu dhe me pak përfaqësues të operatoreve, në mënyrë që ta bëjmë mbledhjen më teknike, të mos e bëjmë kaq të madhe, dhe në fillim të shtatorit e diskutojmë. Ky është mendimi im

Albana Vokshi – Pra, ju propozoni shtyrjen me një muaj, pra nga fundi i korrikut deri në shtator. A është e mjaftueshme apo t’u japim pak më shumë kohë? Në propozimin tuaj të dytë thatë që në shtator të mbledhim një tryezë më të ngushtë, jo kaq të gjerë, vetëm me përfaqësues për të trajtuar edhe një herë problematikën, sepse sot i trajtuam problematikat. Pra, të jetë një tryezë që nga propozimet që do të bëhen këtu, të dalim me dy konkluzione dhe veprime konkrete. Unë nuk mendoj se është e mjaftueshme 1 muaj afat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet diskutuar edhe me operatorët e tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentjan Sala – E para, duhet të bëhet një njoftim dhe, e dyta, platformat e mëdha...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Zoti Arqile, ju më keni thënë se kemi një afat që është 31 korriku, i cili do t’ju digjte të gjithëve dhe tani u bë një propozim konkret, që ky afat të shtyhet një muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë po diskutojmë, jemi këtu për një zgjidhje afatshkurtër që ju të keni një frymëmarrje. Zoti Sala propozoi një muaj shtyrjeje, a është kjo e mjaftueshme? Pra, ne propozojmë që në fillim të shtatorit të kemi një tryezë më të ngushtë dhe teknike për të dhënë dy konkluzione.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, sepse çështjet teknike, nuk mund t’i diskutojmë dot në këtë tryezë!

(Diskutime pa mikrofon.)

Çfarë po kërkon ju?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, sepse e kuptojmë që ju keni halle dhe probleme, por ne jemi mbledhur këtu për ju, pavarësisht mbylljes së sesionit parlamentar. Ne jemi mbledhur këtu, sepse e konsiderojmë çështjen tuaj shumë të sensitive dhe shumë problematike. Pra, ju jemi përgjigjur dje për sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mos na falënderoni, sepse është detyra jonë dhe duhet ta bëjmë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mos më ndërprisni!

Kjo ishte dita më e mundshme që ne të mblidheshim dhe ju kemi ftuar të gjithëve, në mënyrë që të shprehni shqetësimet tuaja. Pra, ne e kuptojmë hallin tuaj dhe, sikurse ju vetë e thatë, duam t'i ndihmojmë televizionet lokale. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse televizionet lokale janë burime informacioni në të gjithë Shqipërinë. Siç e thamë edhe më parë, edhe RTSH-ja ka problemet e saj dhe ka rrethe që nuk kanë sinjal. Dihet rëndësia që kanë të gjitha televizionet lokale, ndaj, hajdeni, që të gjejmë një zgjidhje! Këtu nuk shërben as të nervozohemi, as të ngrihemi në këmbë dhe as të bërtasim. Të ftuar këtu kemi drejtuesit e AMA-s dhe një pjesë të bordit të AMA-s, si dhe drejtuesit teknik të RTSH-së, sepse drejtori i Përgjithshëm nuk ndodhet në Shqipëri. Çfarë mund të bëjmë? Ne kemi propozime konkrete, ndaj, hajdeni, t'i diskutojmë propozimet konkrete!

Një propozim lidhur me afatin, që na e dha zoti Sala, ishte 1 muaj që të gjithë ju mund ta konsideroni të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka edhe palë të tjera, që mund të mos jenë dakord, por ne duhet të gjejmë një zgjidhje të ndërmjetme. Ju thoni se 1 muaj është pak, por mbase 4 muaj, siç thotë zoti Sala, janë shumë, ndaj duhet të gjejmë një afat të ndërmjetëm që t'u shërbejë të gjithëve.

Propozimi i dytë është që në fillim të shtatorit të organizohet një tavolinë teknike, me dy përfaqësues nga ju, me përfaqësues të AMA-s, me përfaqësues të RTSH-së, për t'u dhënë zgjidhje disa prej problematikave që mund të zgjidhen, sepse ato që janë të pamundura, ne nuk mund t'i zgjidhim dot.

Unë po mundohem të përmbledh ato çka ju diskutuat deri tani, të cilat i kemi mbajtur shënim si unë, ashtu edhe zonja Ekonomi. A ka mundësi për rishikim të tarifës, në bazë të standardeve të vendeve të rajonit dhe standardeve europiane? Pra, a ka vend për rishikim apo jo? Unë mendoj se ky grup i vogël që do të mblidhet në shtator, do të mund të diskutojë në tryezë çështjen e rishikimit të tarifave.

Lidhur me reklamat shtetërore, mendoj se duhet të bëjmë një monitorim më të mirë të shpërndarjes së reklamave që financohen nga qeveria për digjitalizimin. Pra, edhe ne mund të nisim një monitorim të asaj çka është bërë deri tani dhe të shikojmë shpërndarjen e reklamës shtetërore në vijim.

Çështja tjetër ka të bëjë me një model të rimbursimit, që ju e ngritët, në mënyrë që të mos jetë një qark, në të cilin unë paguaj dhe rimbursimin e marr diku tjetër. A ka vend që ky rimbursim të jetë më i drejtpërdrejtë, pra pa kaluar një sërë hallkash, por të jetë i drejtpërdrejtë, ku e paguan, atje të merret edhe rimbursimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pjesa e HD, SD, nëse është gjë teknike, kjo tryezë teknike mund t'i japë një zgjidhje. Këto janë disa prej propozimeve apo problematikave që unë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...edhe frekuencën. Tarifën e thashë.

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi - Në fakt këtë tryezë e gjykoj shumë të rëndësishme, pasi shqetësimet që u ngritën janë shumë thelbësore në lidhje me funksionimin e një prej shtyllave kryesore të lirisë së medieeve, siç është media lokale. Unë gjykoj se është një indicie shumë e fortë e ekzistencës së lirisë së medias në një vend. Gjykoj që shteti duhet ta mbështesë median lokale jo vetëm nëpërmjet legjislacionit, por dhe ndërhyrjeve të tjera. Do të thosha se është edhe një element i rëndësishëm i pjesëmarrjes së qytetarit në qeverisjen lokale. Si të tillë duhet të gjykojmë se jemi para një problemi shumë akut, pasi alarmi për eliminimin e kësaj medie duhet patjetër që të na vërë në veprim si komision, por edhe si ente shtetërore qoftë AMA-n, qoftë edhe RTSH-në. Unë pak a shumë e njoh mirë problemin, sepse kam qenë pjesë e diskutimeve dhe tryezës që është bërë para një viti e gjysmë, dhe e diskutimeve të tjera në vazhdimësi për rrjetet frekuencore dhe të drejtat që kanë pasur televizionet lokale, sipas ligjit nr.97/2013 për të pasur frekuencat e tyre. Është kërkuar nga televizionet lokale, po bëj pak histori, do të më falni që po zgjatem, por po them të vërtetën, kjo është penguar nga AMA që ato të ishin pjesë e zotërimit të frekuencave të caktuara, për shkak të rrethanave të luftës politike, klientelës, gjëra të cilat ne i kemi debatuar në legjislaturën e kaluar. Ndodhi ajo që u parashikua. Në vazhdimësi u shtuan rrjetet frekuencore: nga 5 u bënë 7, madje debati ka qenë për RTSH-në, kjo ishte zgjidhja që kapërceu ligjin nr. 97/2013, sepse po u referohem të gjitha diskutimeve që janë bërë, të ishte në dispozicion të televizioneve lokale dhe është shumë e rëndësishme, pasi është pjesa e detyrimeve që ka shteti për të mbështetur televizionet lokale nëpërmjet televizionit publik. Sot televizioni publik nuk mund të dalë dhe të sillet me televizionet lokale si subjekt privat, jo. Është televizion publik. Nuk e arritëm këtë gjë, megjithëse u bë shumë luftë nga opozita. Të gjithë e dimë historinë. Para

një viti e gjysmë zhvilluam një tryezë me iniciativën tuaj. Debati ka qenë shumë i ashpër, arritëm vetëm një fitore, nëse e mbani mend: një vit mbartja te rrjeti frekuencor i TVSH-së të bëhej falas, por patëm edhe një dakordësi në tryezë, ju ndoshta nuk e mbani mend, por unë po i referohem kujtesës sime. Pagesa e mbartjes do të ishte nën kosto dhe jo mbi të. Këtu u tha të ngrihet një komision, për të cilin unë jam dakord, që të masë kostot aktuale të mbartjes, sepse diferencat nga Kukësi në alokmentin Tiranë-Durrës dhe në alokmentet e tjera shikoj se është shumë e madhe dhe të thuash se kostoja është më e madhe në Tiranë dhe është më e vogël në Kukës, nuk shkon, madje është e kundërta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Kjo është çështje konkurrence, çështje shikueshmërie, klikimesh dhe të absorbimit të reklamës nga ana e publikut. Gjykoj se ne duhet t'i rikthehemi kësaj marrëveshjeje që do të jetë nën kosto, sepse është detyrim i televizionit publik, meqenëse u kapërcye ligji "Për mediet audiovizive" për televizionet lokale që ta ofrojnë këtë shërbim, është një rrjet frekuencor më shumë. Kryetari i AMA-s tha se nuk ka ndodhur në asnjë vend, është e vërtetë, por me këtë logjikë e ka të përcaktuar dhe strategjia që këto televizione të mos jenë në vështirësi financiare, pasi ka edhe një problem shumë të madh, rrjeteve frekuencore u është dhënë e drejta, licenca. Shumë prej operatorëve kishin bllokuar, sikurse televizionet locale, frekuenca të caktuara, por u gjet një zgjidhje e diferencuar e papranueshme, ata që morën rrjetet frekuencore, me VKM u kompensuan me 5 milionë euro. Sot, thotë AMA se për lirimin e frekuencave ka kosto. Në fakt, ligji e detyronte që sapo të merrte licencën, duhej të ikte menjëherë nga frekuenca. Kjo nuk u zbatua asnjëherë dhe u shkel ligji në mënyrë absolute. Jo vetëm që u shkel, pasi normal televizioni është gjë e madhe, iu dha edhe një kompensim, jam dakord, duhet të mbështetet, është specifik. Dikush tha se është privat. Jo, televizioni nuk është privat. Aktiviteti juaj është privat, por është e mirë publike, është shumë specifik. Nuk po shet portokaj apo këpucë. Në analogji unë kërkoj dhe propozoj që siç u kompensuan operatorët për rrjetet frekuencore, të kompensohen të gjitha televizionet lokale nga shteti. Është humbje teknologjike, humbje financiare, është një teknologji ku dikush mund ta kishte blerë 3 muaj para miratimit të ligjit, dikush 2 muaj, dikush 3 vjet më parë, por çështja është që të ngrihet një komision dhe televizionet locale, sikurse operatorët që morën përsipër rrjetet frekuencore, se edhe këto e pësojnë dëmin, të merrnin një kompensim financiar, krahas atij njëvjeçari, që mendohej se duhet të ishte kohë më e gjatë për t'u mbartur

falas, meqenëse nuk vihen në dispozicion për grupe të caktuara operatorësh dhe janë kërkuar me forcë frekuenca të veçanta. Është e drejta juaj për të kërkuar një gjë të tillë.

Në lidhje me problemet që paraqiti Fejzo, Mondi dhe të tjerë janë çështjet e rimbursimit, u tha edhe nga zonja kryetare, kur u vendos çështja e tarifës, nuk ka pse bëhen kapërcime pindareske rimbursimi, është falas 1 vit, nuk paguhet, fillon pagesa vitin tjetër. Bëhet një marrëveshje. Nuk besoj se ka ndonjë vështirësi financiare për të realizuar një element dhe një gjë të tillë.

Problemi tjetër që duhet të ketë patjetër televizioni lokal, unë gjykoj se në situatën që jemi për kalimin simultan të transmetimeve, pasi ishte problemi i fundit që diskutuam, ju kërkon një shtyrje të afatit, sepse është ndër thelbet e diskutimeve tuaja. Përfundon më 31 korrik. Thuhet në shtator, por shtatori një muaj është, sepse kur është 31 korriku, korriku s'logaritet, pra është vetëm një muaj.

Tani, keni të drejtë, sepse dëgjova edhe në lidhje me elementët teknikë, që nuk ju leverdis nga ana financiare ta keni simultane: edhe analoge, edhe digjitale. Por ka një element shumë të rëndësishëm, jemi në kuadrin e monopolit. Sot të drejtën dhe aftësinë për t'ju mbartur juve e ka vetëm RTSH-ja, por RTSH-ja e ka detyrim. RTSH-ja nuk po e trajton si detyrim publik, po e trajton si biznes. Në kuadrin e tregut ndodhemi në situatën monopol. Pse jemi monopol? Sepse vetëm RTSH-ja e ka.

Janë dhënë pesë licenca të rrjeteve frekuencore. Po, unë jam dakord nëse do të isha operator dhe në qoftë se do që të trajtohem vërtet si konkurrent në një biznes, atëherë më krijo treg konkurrence dhe unë do të zgjedh RTSH-në, do të zgjedh X-in, këdo që ka marrë rrjetet frekuencore, sipas çmimeve. Listohen çmimet dhe unë them: po, ky çmim më leverdis dhe shkoj aty.

Në kushtet kur ne nuk e kemi këtë bonus, që në fakt duhej të ishte, sepse është detyrë e AMA-s që ta ndjekë digjitalizimin, digjitalizimi të fillojë, megjithëse strategjia, siç më thotë drejtori teknik, është pesë vjet në dispozicion. Pra, rrjeteve frekuencore u lihen pesë vjet në dispozicion që ta bëjnë ose, në fund fare, edhe të mos e bëjnë, sepse mund të dorëzohen dhe financiarisht nuk e bëjnë dot. Mund të ndodhë edhe kjo.

Po televizioneve lokale, pse u kërkohet me zor që ta bëjnë patjetër pagesën? Jo, duhet t'u lihet një afat simuluan, derisa të krijohet tregu. Ne s'kemi treg, është monopol. A e kuptoni? Mua

më duket e paarsyeshme kjo, që pa pasur një treg, unë të shkoj te RTSH-ja, e cila, plus kësaj, e ka edhe detyrim publik që ta bëjë në kosto, dhe thotë: 1000 euro. Po unë s'kam ku të shkoj; nëse s'i paguaj 1000 euro, më duhet ta mbyll televizionin. Nuk shkoj dot te "Top"-i, nga inati i RTSH-së, që të paguaj 1200!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem! Jo, jo, nuk është ashtu, sepse nuk janë ndërtuar rrjetet. Pra, kur të përfundojë ndërtimi i rrjeteve frekuencore, ky është tregu, konkurrencën e keni të hapur. Edhe ju, si RTSH, hyni në konkurrencë me rrjetet e tjera. Në qoftë se keni çmime, që i vendosni me marrëveshje, kjo është çështje tjetër, por ama ka treg.

Tani, pa pasur treg, duke pasur detyrim publik ndaj televizioneve lokale dhe duke qenë monopol, ju e trajtoni sikur këta po trokasnin me zor vetëm në një portë. Jo, nuk është e drejtë kjo; as qëndrimi i RTSH-së, që kemi bërë një marrëveshje në kosto, kur është detyrim edhe nga strategjia, edhe nga ligji. Aq më tepër, kur s'ke konkurrencë me rrjetet e tjera frekuencore, favorët duhet të jenë të dukshme për televizionet lokale.

Nuk po them se RTSH-ja duhet të paguajë nga kostoja e vet. Jo, jo, në këtë rast duhet të ndërhyjë qeveria me subvencion për televizionet lokale. Me këtë jam unë. Nuk jam kundër RTSH-së. RTSH-ja është publike. Është bërë punë gjigante, gjë për të cilën, sigurisht, digjitalizimi duhet falënderuar. Të jemi koshientë për këtë. RTSH-ja ia ka arritur kësaj. Unë e di se RTSH-ja ka kosto shumë të mëdha, por të dalim në një konkluzion, të jemi bashkë në këtë rast. Që RTSH-ja të mos jetë në vështirësi financiare dhe t'ju marrë juve shpirtin, duhet t'i thotë qeverisë: më subvenciono, sepse unë kam marrë përsipër, e kam për detyrë nga strategjia dhe nga ligji, që të kemi edhe televizionet lokale. Prandaj po bëj rrjetin frekuencor, sepse ma ke detyruar ti si shtet. Është e detyrueshme.

RTSH-ja është në pozitë të vështirë. Pra, të gjejmë ato zgjidhje që na përshtaten. Kemi dy palë që kundërshtohen: RTSH dhe televizionet lokale. Jo, ne jemi bashkë, për një qëllim. Qëllimi është t'i shërbejmë publikut në një mënyrë sa më të mirë, duke zbatuar edhe kërkesat e BE-së për digjitalizimin. Këtu le t'i bëjmë presion çdo lloj qeverie, sepse nuk është se po zgjidhet sot problemi dhe është në rregull, por t'i bëjmë presion çdo lloj qeverie, që të ketë mbështetje subvencionuese, që të ekzistojë televizioni lokal, por edhe RTSH-ja të mos jetë në vështirësi financiare, sepse është në vështirësi financiare në rastin kur hyn në marrëdhënie të tilla. Prandaj

sillen sikur janë në treg. Ne duhet ta heqim këtë ide. Ne duhet të mbështesim edhe RTSH-në, por edhe televizionet lokale.

Prandaj gjykoj se kjo çështje është e rëndësishme: licenca s'ka pse jepet vit për vit. Përderisa marrëveshja e qirasë, e mbartjes, është një herë në vit, licenca të jetë një herë në pesë vjet.

Ky është një propozim ligjor, që komisioni ynë mund ta bëjë me iniciativën e vet, në ligjin përkatës, ose një vendim, që të shohim se sa është aftësia dhe e drejta e AMA-s për të marrë një vendim të tillë. Besoj se edhe AMA e ka një vendim, sepse është autoriteti që merret me këtë gjë. Mund ta shtyjë dhënien e licencës në një afat trevjeçar ose pesëvjeçar, si ta gjykojë. Vit për vit është shumë e lodhshme, jo procedurat, jo pagesat. Pra, duhet t'i lidhim dhe t'i gjykojmë gjërat.

Unë kaq desha të thosha. Ndoshta u zgjata, por e bëra ngaqë e njoh një çikë problemin. Pra, cili është konkluzioni? Të gjejmë zgjidhje të përbashkëta duke ndihmuar RTSH-në, por duke ndihmuar edhe televizionet lokale.

Qëllimi juaj është i përbashkët. Ju keni funksion publik në këtë rast. Hajdeni të gjejmë një zgjidhje. Kjo është. Edhe në lidhje me tryezën e propozuar në shtator jam dakord. Ndoshta jemi lodhur, por rasti juaj nuk ka lidhje as me lodhjen politike e as me sesionin, është problem shumë akut dhe shumë i rëndësishëm.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Boçi!

Unë dua të risjell në vëmendje, që përderisa e kemi konsideruar shumë të rëndësishme çështjen e digjitalizimit, në komision, kur kemi diskutuar buxhetin e 2018-ës, i gjithë komisioni, në mënyrë unanime ka qenë dakord për fonde shtesë nga buxheti i shtetit, për të mbuluar shpenzimet e digjitalizimit.

Pra, si komision, ne jemi përpjekur të jemi mbështetje për RTSH-në për sa i përket procesit të digjitalizimit. Prandaj, po ashtu, sot është dita të mundohemi të mbështesim të gjithë televizionet lokale, me të gjitha format që mundemi, me qëllim që të konkludojmë në zgjidhje.

Po ia kaloj fjalën zonjës Ekonomi, e më pas zotit Baçi.

Milva Ekonomi – Zonja Vokshi, unë do të flas shumë shkurt, sepse në përgjithësi gjërat u thanë. Ajo që dua të shtoj është: në lidhje me çështjen tuaj, sensibiliteti në komision është shumë i lartë, nga të gjitha palët politike.

Keni dërguar një letër dhe kjo është arsyeja pse të gjithë jemi mbledhur këtu së bashku, por vijmë me një mendim të konsoliduar tashmë. Ju e dëgjuat se për ne, digjitalizimi është konsideruar gjithmonë një hapje, një mundësi më e madhe për publikun, për të pasur më shumë kanale të lira dhe pa pagesë.

Për këtë arsye, kur kemi filluar të diskutojmë digjitalizimin që po bëhej në RTSH, natyrisht kemi kuptuar se RTSH-ja ka nevojë për investime. Buxheti i këtij viti nuk i mbulonte të gjitha nevojat, ndaj ne bëmë presionin pozitiv që mund të bëhej në hartimin e një buxheti, për të pasur më shumë pagesë. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe jemi përpjekur të ndjekim edhe ecurinë e procesit. Jo ne vetë, sepse nuk e kemi kompetencën e ndjekjes së zbatimit të digjitalizimit, por ka operatorë të ndryshëm, që vijnë nga organizata ndërkombëtare. OSBE-ja është njëra nga këto; *European Broadcasting Union* është një institucion tjetër që bën këtë ndjekje. Nëpërmjet tyre, ne jemi përpjekur të marrim një informacion se si po shkon digjitalizimi.

Në momentin kur e kemi kuptuar se RTSH 2 është për ju një platformë për t'u instaluar, po ashtu jemi munduar kuptojmë se çfarë situatash do të keni ju, si transmetues lokalë, në këtë pozicion.

Prandaj, unë konsideroj se tavolina e sotme është diçka shumë e rëndësishme, është një sistem i ri për ne, është një gjë e re, ka momentet e veta të kolaudimit dhe ky është një moment kolaudimi. Ka gjëra që kanë nevojë për më shumë vëmendje, që të funksionojnë më mirë.

Ja, këto janë problemet. Unë dua të shtoj edhe një vëmendje tjetër, që, meqenëse ne duhet të jemi shumë neutralë në kuptimin që të mos kemi influenza nga palët kur marrim vendim, nuk ka qenë vetëm RTSH-ja që kemi dëgjuar, por kemi dëgjuar edhe AMA-n në mënyrë individuale se çfarë problemesh ka.

Vendosja juaj në platformën RTSH 2, ndërkohë që ne kemi edhe një aplikacion në telefon, që nganjëherë, padashur, jo se do të ndjekësh gjë, por ti e shikon a po mbushen kanalet e RTSH-së apo jo, bën një lloj monitorimi personal. Jemi përpjekur ta ndjekim këtë. Unë besoj te tavolina që do të vijë, e cila ka disa qëllime kryesore: frekuenca është një gjë që po diskutohet, ndërkohë po diskutohet edhe mënyra si po tariforet. Ne kërkojmë që tarifimi të jetë një proces që ka ulur 50% në harkun kohor të 2 vjetëve. Çfarë mundësie ka tarifimi të ndjekë një logjikë kostoje që është logjikë e ngjashme me vendet e rajonit? A ka mundësi që të kemi influencën tonë për këtë?

Na ana tjetër, ne kuptojmë se edhe koha që është vënë në dispozicion me kompensim nga shteti për një vit, nuk është në një platformë private që mund të shkohet, po është një kohë që tregon se edhe kolaudimi brenda jush ka nevojë për më shumë dialog me të gjitha palët.

Duke diskutuar me Albanën, ramë dakord që kjo tavolinë e rrumbullakët teknike të mbledhet sa më shpejt, por, në fakt, na kërkon edhe pak punë gjatë gushtit, sepse është periudhë pushimesh, që të përgatisim disa nga këto shënime me fakte dhe kërkime konkrete për gjërat.

Unë shoh se disa nga ju janë bërë gati për të nënshkruar kontratën me RTSH-në, por kanë probleme se është jo vetëm hap i madh revolucionar teknik, por është edhe hap besimi. Unë besoj se në shtator do të jetë një gjë e mirë dhe ne do të jemi të gatshëm për të ndihmuar me sa të mundemi, duke e ditur se digjitalizimi tani është një proces që nuk kthehet më pas dhe do të ketë suportin tonë të pafund.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Zoti Baçi, urdhëroni!

Luan Baçi - Faleminderit!

Në fakt, shqetësimet dhe problemet që ngrenë operatorët e televizioneve lokale janë saktë dhe thjesht të listuara në shqetësimet që ata kanë ngritur dhe na i kanë vënë mbi tavolinë.

Unë do të thosha se midis tyre nuk duhet përzgjedhur një po, një jo, por unë mendoj se janë të gjitha të argumentuara më së miri dhe jo të fryra, por janë shqetësime konkrete.

Mendoj se të fryra kanë qenë masat që ka marrë AMA në fillim, duke bërë ato propozime të paimagjinueshme, siç thonë vetë pronarët e medieve, për tarifën që duhet të paguajnë; po marr shembull Fierin me 2000 euro apo Vlorën me 1500 euro e me radhë të gjithë të tjerat. Mendoj se të gjitha këto duhem marrë mire parasysh nga Komisioni i Medias për t'i dhënë propozimet e duhura AMA-s, pasi është institucion që vendos vetë.

Në fakt, përveç zonjës Ekonomi si përfaqësuese e maxhorancës, vetëm opozita është sot në këtë tryezë për t'i thënë gjërat siç janë, por mendoj se kolegët do të jenë dakord me ato që ju do të thoni...

Milva Ekonomi – Do të shtoja se disa nga ata janë me detyra jashtë Tiranës dhe dy nga deputetët kanë marrë leje.

Luan Baçi – Kjo është krejt e pranueshme se jeni në pushtet dhe keni edhe punë të tjera.

Unë do të shtoja diçka konkrete. Të flasësh pas zotit Boçi, është shumë e vështirë të bësh analiza të tilla, sepse ai i bën në mënyrë shteruese, por unë do të sjell vetëm një shembull, që mediet

lokale të Qarkut të Fierit, zoti Rustemi që është i Tv Apollon dhe zoti Sulejmani i Tv Jug, të cilët janë prezentë, gjithashtu janë edhe dy televizione të tjera lokale, të cilët kanë bërë një kërkesë për marrjen e frekuencës së lirë në bazë të ligjit, që çdo qark ka një frekuencë të lirë.

Fieri e ka bërë këtë kërkesë pranë AMA-s, e ka bërë brenda afatit, se u është thënë shpeshherë “se po dolët nga afati do të digjeni dhe s’keni më të drejtë të transmetoni”. Nuk e di për qarqet e tjera a e kanë bërë këtë kërkesë pranë AMA-s për të marrë frekuencën e lirë të qarkut, e cila u takon me ligj. Për Fierin që e ka bërë këtë kërkesë, përse nuk i kthehet përgjigje dhe çfarë vendimi do të merret?

Ata kanë rënë dakord që 4 media lokale të Fierit, Apolon, Jug, Kombi dhe AVN, kanë bërë kërkesën dhe e duan frekuencën për Qarkun e Fierit dhe nuk duan të jetë te platforma e TRSH-së, por të kenë frekuencën e tyre.

Unë mendoj se kjo është një nga kërkesat kryesore që kanë të gjitha qarqet që kanë televizione lokale, se do të ndiheshin shumë herë më mirë po të menaxhonin veten, kundrejt taksave, tarifave dhe detyrimeve që ka shteti.

Mendoj se është një nga kërkesat kryesore që zotërinjtë e pranishëm kanë dhe nëse ju realizohet kjo kërkesë, nuk do të kenë shumë kërkesa të tjera në këtë marrëveshjen që duhet të kenë me RTSH-në.

Mendimi im personal, që uroj të mos jetë kështu, kjo është një platformë që shkon drejt eliminimit të medieve lokale. Unë jam i sigurt se edhe në tryezën që do të bëjmë në shtator apo në tryezat e tjera, më vjen keq që jam skeptik, por nuk besoj se do të zgjidhni shumë probleme me këtë mënyrë. Duhet të dini edhe një gjë, se jeni shumë të fuqishëm, por ju nuk e dini sa të fuqishëm jeni. Jeni shumë të fuqishëm se ju jeni biznese, por nuk jeni biznese të vetes suaj, se ju nuk shisni domate dhe banane, por shisni informacion, që është shumë i rëndësishëm për qytetarët. Jeni kaq të fuqishëm në marrëdhëniet me qytetarët, sa po ta sensibilizoni çështjen, do të kenë edhe reagim nga vetë qytetarët.

Është e vërtetë ajo që tha zoti Rustemi, se shumë qytetarë të Fierit e kanë kërkuar kanalin Tv Apollon dhe jam dakord me ju, zoti Sala, që vërtet Fieri ka shumë kabllorë dhe nuk keni parë antena, por ju keni parë vetëm qytetin e Fierit, se Fieri si bashki është 200 mijë banorë dhe 100 mijë banorë banojnë në zonat rurale. Zonat rurale janë të gjitha me antenna, se janë të varfër, janë aq të varfër sa nuk ju shkon mendja për të blerë dekoderin që qeveria me anë të RTSH-së po ua imponon ta blejnë, që të kenë falas stacionet.

Si konkluzion mendoj se duhet ta ndiqni problemin fort. Ne do t'ju mbështesim ju si qytetarë, por edhe si deputetë të parlamentit. Dëshiroj shumë që këtë radhë të ishin dakord edhe deputetët e maxhorancës, sepse, po të jemi të gjithë dakord, kërkesat tuaja realizohen të gjitha.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po, Kejdi. Pastaj drejtori teknik do të bëjë dy sqarime për çështjet që ju keni ngritur. Do t'i përsëris edhe një herë propozimet që janë bërë, në qoftë se jeni dakord, ta mbyllim takimin dhe e rifillojmë pas një muaji.

Kejdi Mehmetaj – Dashur pa dashur, ne kalojmë në përsëritje të njëri-tjetrit, sepse janë të njëjtat çështje dhe për ato çështje do të diskutojmë. Në fakt, ne si komision kemi pasur një sensibilitet shumë të madh që në momentin e parë kur kemi marrë letrën tuaj. Kemi diskutuar disa herë me kryetaren dhe me nënkryetaren për çështjet që ju keni ngritur, të cilat duhet të gjejnë zgjidhje në mënyrë të shpejtë. Arsyeja kryesore është se qytetarët që nuk jetojnë në Tiranë, por në qytete të tjera të Shqipërisë nuk e gjejnë shumë veten tek televizionet kombëtare, pra e kam fjalën për shqetësimet e tyre të përditshme, lajmet, evenimentet në zonat e tyre, të cilat përgjithësisht nuk transmetohen nga televizionet kombëtare, siç transmetohen nga ato lokale. Ne që kemi jetuar nëpër qytete të tjera, e dimë rëndësinë e madhe që kanë kanalet lokale për qytetarët. Ndaj, përpjekja jonë do të vazhdojë edhe në muajin shtator, por edhe më pas, që problemet që u ngritën të marrin zgjidhje.

Përtej atyre që u thanë, kam disa shqetësime të cilat dua t'i ngre.

I pari, ka të bëjë me qasjen e RTSH-së në lidhje me televizionet lokale dhe me transmetimet. Duhet të jemi të qartë edhe në komunikim, jo thjesht ligjërisht dhe në strategjitë që ju keni, se frekuenca e dytë në dispozicion të RTSH-së, në fakt, është vendosur për t'u shërbyer televizioneve lokale. Në diskutimin tuaj çështja e transmetimit duhet të trajtohet si një treg i lirë, që transmetuesit të shikojnë se cili opsion është më pak i paguar, që të marrin shërbimin. Përkundrazi, RTSH-ja me ndërmjetësimin e AMA-s, pa diskutim, duhet të krijojë mundësinë që, nëse kjo frekuencë nuk u vihet në dispozicion transmetuesve lokalë, ta përdorin ashtu siç e shohin më të arsyeshme, duke qenë një grup, se një i vetëm nuk e përballon dot, atëherë nëpërmjet jush ata do të marrin shërbim më të mirë dhe me koston që mund ta përballojnë. Pra, ashtu siç u shpreh edhe një parafoles, duhet të shikohet kostoja e subjekteve, vështirësitë që ata kanë, me qëllim që të merret edhe një vendim.

Që të jem e qartë me përfaqësuesin e RTSH-së, edhe ne si deputetë nuk i presim të gjitha zgjidhjet nga ju, pra i kuptojmë pozicionin tuaj dhe shpenzimet që ju keni. Unë i bashkohem mendimit të zotit Boçi për punën që keni bërë, që është shumë e madhe, por në rastin konkret, lidhur me televizionet lokale ju nuk jeni konkurrues në treg. Frekuencën e dytë duhet ta vini në dispozicion të televizioneve lokale. Këtu i kthehem diskutimit për AMA-n, e cila ka rolin thelbësor në këtë çështje, sepse duhet të jetë rregullatore. Në rastin e televizioneve lokale mendoj se duhet të jetë më shumë mbrojtëse se kërkuese, duke pasur parasysh vështirësitë që ato kanë në transmetim. Edhe ne si deputetë të LSI-së, këmbëngulim që jo vetëm të rishikohen tarifat, të shtyhet koha (nuk po i përsëris këto, meqë u thanë më parë), por të gjendet patjetër një zgjidhje për të ndihmuar në nivel ekonomik transmetuesit lokalë, duke u rimbursuar teknologjitë, të cilat u kanë dalë jashtë përdorimit apo të gjendet një model tjetër me detyrimin në shtet që, nëse ky i fundit nuk e disburson, të lërë hapësira që për një periudhë disavjeçare të mos paguajnë licencat, derisa të përlllogaritet kostoja e shpenzimeve që ato kanë pasur për ndryshimin e teknologjisë. Është e rëndësishme që kjo të jetë temë thelbësore diskutimi edhe në tryezën që ju do të keni në shtator.

Për sa i takon pagesës 1-vjeçare, ne kërkojmë të ketë një rishikim të saj, sepse dyshimi i parafolësve për çështjen e rimbursimit është shumë i drejtë, sepse mund të ndodhë e njëjta gjë si me TVSH-në që bizneset presin të marrin rimbursimin e TVSH-së, por kalojnë vite dhe ata nuk e marrin. Pastaj çfarë kuptimi do të ketë nëse të gjithë pronarët, presidentët apo drejtuesit e medieve lokale do ta marrin rimbursimin pas 3 apo 4 vjetësh, kur si rrjedhojë e kostove të mëdha televizioni i tyre edhe mund të jetë mbyllur fare? Kjo është një tërheqje vëmendjeje nga ana jonë që ta keni parasysh në tryezën që do të mbani në shtator.

Pa dyshim, janë edhe gjordat për të cilat u fol. Unë ngrita dy shqetësimet kryesore që kishin të bënin me pjesën ekonomike dhe sjelljen e RTSH-së, meqenëse pjesa tjetër u diskutua. Kolegia thotë që, meqenëse kjo është një periudhë transitore, duhet të merren të gjitha parasysh në tryezën e shtatorit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po i kaloj fjalën drejtorit teknik të RTSH-së për dy sqarime, pa replikuar, vetëm sqarime.

Për ta përfunduar, do të bëj një propozim konkret që kam unë.

Henri Muça – Do të bëj dy sqarime të shkurtra.

E para, pozicioni i RTSH-së në lidhje me televizionet lokale është shumë i saktë. E them këtë, sepse kemi që më 1 dhjetor të vitit 2016 që transmetojmë mbi 10 kanale në muksin e dytë, pra të gjithë operatorët lokalë të Tiranës, pa asnjë pagesë, sepse e dimë që digjitalizimi është në periudhë transitore për televizionet lokale dhe RTSH-në, për operatorët e tjerë jo. E dimë që nuk është fikur analogu ende në Tiranë. Prandaj edhe ne nuk kemi aplikuar... Kemi të drejtë, se shpenzojmë para, se ato janë para publike, mirëmbajtje, kosto, njerëz, naftë; pajisjet, gjithashtu, i kemi me këste, por i paguajmë. Mund të thonë se do t'i ndezin këto kanale vetëm kur të fillojë fikja e analogut, atëherë do të marrin edhe pagesën. Nuk po e bëjnë këtë. Tani bëhen dy vjet.

Në lidhje me sinjalin, RTSH-ja kohët e fundit ka pasur shumë zhvillime teknologjike. Nuk po flas për ato programore, sepse unë jam këtu vetëm për pjesën teknike. Kjo shtyrja pa fund e procesit të digjitalizimit, ka kosto për televizionet lokale, por ka edhe shumë kosto për RTSH-në, sepse po mbajmë ndezur një rrejt analog që ka qenë shumë i amortizuar, pra ka qenë me probleme, ku pushteti lokal duhej të paguante energjinë elektrike, ndërkohë nuk e paguan energjinë elektrike dhe ankesa vjen prapë te RTSH-ja. Domethënë, problemet politike dhe ato ligjore nuk di t'i shpjegoj unë, sepse s'janë teknike.

Meqenëse ne po presim të dixhitalizohemi, nuk investojmë dot në analog. Megjithatë, rrjeti analog është përmirësuar. Po i referohem sinjalit të Lezhës, ai është dixhital, mjafton të kemi dekoderin, të cilin do ta kemi shumë shpejt.

RTSH-ja ka 54 stacione të ndezura sot, pas dy muajsh do të ndizen të gjitha dhe ne jemi gati për të fikur analogun, por kemi problemin e dekoderave, që sapo thamë, sepse RTSH-ja nuk shet asnjë dekoder dhe nuk fiton asnjë lekë nga dekoderat që shesin të tjerët. Ne do të donim të fikej analogu, në mënyrë që e gjithë popullsia të merrte shërbime dixhitale, 12 kanale. Shërbimet tona nuk janë vetëm tokësore, por kemi edhe 6 kanale satelitore, nga një kanal në MPEG2 SD dhe 4 HD. Kemi disa kanale në platformën IOS dhe Android në telefon dhe po të njëjtat kanale që janë këtu janë dhe në televizor Android dhe në dekoderat Android dhe shumë shpejt edhe në televizorët Samsung. Domethënë, nga ana teknologjike, RTSH-ja mund të mirëpresë edhe lokalet në platformën e saj. Kjo është në strategjinë tonë për të bashkëpunuar me lokalet, por që ne të llogarisim një kosto në kurriz të RTSH-së dhe publikut, sepse ato janë para publike, për t'i dhënë transmetimin e dytë komplet lokaleve, kjo teknikisht është e mundur, por...

(Ndërhyrje pa mikrofoni)

...teknikisht është e mundur, po nuk e di si do t'ia bëjmë për uljen e kostos. Këtë e kam bindje.

Ky ligj është i përcaktuar, strategjia është bërë, pajisjet janë blerë dhe frekuencat janë ndarë. Një transmetues i Durrësit do të transmetojë vetëm në Durrës, por, kur vjen te RTSH-ja merr Tiranën, Durrësin, Krujën dhe Kavajën. Në këtu kemi gjashtë transmetues të ndezur, por nëse ai do vetëm një, ne nuk e ndajmë dot çmimin për gjashtë. Ky është problemi që ju del tarifa e lartë, sepse ju keni pasur një transmetues në Kavajë dhe thoni jam lokal i Kavajës, por tani nuk keni transmetues në Kavajë. Me strategjinë e re..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me strategjinë dhe me mundësinë teknike që ka RTSH-ja sot për ju, duhet t'u japë patjetër të gjithë paketën e Tiranës me gjashtë transmetues. Prandaj është kjo kosto dhe nuk është e shtrenjtë për gjashtë transmetues, sepse aty përfshihet energjia elektrike, pajisjet e reja, që nuk i paguani, por vetëm i mirëmbani, pajisjet me *redundance*, gjeneratorët me *redundance*, nafta e të tjerë. Kjo kosto nuk është e shtrenjtë për gjashtë transmetues, por që të paguani vetëm një, hajde ta diskutojmë, sepse ndoshta mund të bëjmë ndonjë ndryshim teknologjik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është bisedë teknike, jo tavolinë teknike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Ju lutem!

Të flasë Mondit, pastaj Samiu, ndërsa unë do t'ju bëj propozimin konkret që kemi.

Edmond Isaku - Zonja kryetare, edhe një herë ju falënderojmë për gjithçka që bëtë sot dhe për të gjithë dëgjimin!

Po të futemi në çështje teknike, ne nuk ia dalim dot. Kërkesa që kemi bërë në është e saktë, ka katër pika dhe duhet t'u përmbahemi atyre, sepse për ato kemi ardhur. Ne kërkojmë frekuencën lokale, rimbursimin e teknologjisë, që iku, kërkojmë për ata që duan të hyjnë të implementohen në platformën e RTSH-së, uljen e tarifës dhe ndonjë problem tjetër, që i keni të shkruara aty, por për momentin nuk më kujtohet. Këto janë problemet.

Lidhur me shtyrjen e afatit, unë jam dakord të pyeten edhe televizionet e tjera kombëtare, sepse nuk jemi vetëm ne. Kjo është një çështje që duhet të diskutohet me kryetarin e AMA-s dhe me ju. Shtyrja e afatit nuk varet vetëm nga ne, mund të jetë shtatori, por unë them më mirë të kalojë

në dhjetor, sepse nuk bëhen gati aq shpejt. Ju bëjeni si të doni, neve nuk na prishë punë, por duhet të shtyhet, sepse nuk kemi rënë akoma dakord.

Albana Vokshi – Faleminderit, Mondi!

Ju lutem, vetëm dy fjalë, sepse më duhet të konkludoj.

Aristotel Petro - Do të mundohem të flas shumë shkurt.

Propozimi im lidhet me frekuencat, sepse ato nuk janë të zëna në të gjithë Shqipërinë. Për shembull, Gjirokastra është një nga ato zona ku ka frekuenca të lira, pse të mos lejohet aty dhe të na jepet një *allotment* edhe neve.

Propozimi tjetër është që ne si media lokale të mos kemi persekutime apo padrejtësi nga konkurrenca e pandershme që na bëjnë drejtpërsëdrejti TVSH-ja dhe kanalet e tjera.

Albana Vokshi- Faleminderit!

Atëherë, kam përshtypjen që është edhe një çështje që mund të zgjidhet në mbledhjen tjetër. Atje ku ka frekuenca të lira, të shihet mundësia. Unë shoh që ka një lloj kontradikte këtu, por që mund të zgjidhet. Të shihet mundësia, të paktën, në Kukës, në Gjirokastrë ose në rrethe të tjera, ku aktualisht ka disa të lira.

Atëherë, Sami të lutem!

Sami Nezaj – Dua të flas shumë shkurt për pagesat e tarifave vjetore të licencës, që erdhën më shumë si propozime nga deputetët sesa nga përfaqësuesit e televizioneve lokale. U fol këtu për ndryshimin e skemës së këtyre pagesave dhe unë mendoj se kjo nuk duhet konsideruar nga ju, për shkak se kjo ka të bëjë me cilësinë e pavarësisë së autoritetit rregullator. AMA mbahet nga tarifat vjetore të licencës dhe çdo ndërhyrje në këtë skenar ose në këtë skemë të pagesës së operatorëve në drejtim të AMA-s mund të çonte në komplikacione të pavarësisë së rregullatorit. Është çështje tjetër tarifa që paguajnë televizionet lokale tek TVSH-ja, që duhet ndërhyrë dhe duhet rishikuar plotësisht, por kjo tjetra nuk ka të bëjë fare me problemin e sotëm.

Luçiano Boçi- Meqenëse në këtë rast isha unë propozuesi, ju e ngritët shqetësimin, se na u drejtuat neve, në fakt, unë e kisha për çështje kohore dhe burokraci të dokumentacionit. Pra, në qoftë se paguhet për tre vjet, të bëhet një herë në tre vjet ose një herë në pesë vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, të jemi të qartë në këtë rast, jo që licenca në koston që ka të paguhet vit për vit, por të paguhet bashkë në tre vjet, pa e dëmtuar autoritetin financiar, sepse mund të shohë politikat e pagesës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është tjetër gjë; edhe mund t'i ulë dhe nuk i dëmton.

Gentian Sala – Do të ndërhyjë edhe shteti.

Luçiano Boçi – Por edhe mund t'i ulë. Megjithatë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, një minutë, se kam një propozim tjetër!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, do ta mbyllim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, Fejzo, nuk ju dëmtoj, sepse ajo rritet vit për vit, por ti nuk po e kupton!

Propozimi tjetër, se dëgjova këtu: gjobë Kukësi, persekucion Gjirokastra, në fakt, AMANISËT nga kuadri ligjor, meqenëse debatin e keni bërë në një formë a në një tjetër dhe duhet propozim. Në fakt, iniciativa duhet të jetë politike. Në këtë rast, ne, si deputetë, duhet ta ulim pjesën e propozimeve ligjore që gjobat të mos jenë maksimale, pasi televizionet lokale mund të bëjnë shkelje ligjore gjatë aktivitetit të tyre, por jo penalteti të shkojë në 10 milionë për ta falimentuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi një shprehje në Elbasan: “T”i ngjajë peri gëzofit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, pra, gjoba të jetë aq e arsyeshme sa... Domethënë, gjoba të paguhet dhe televizioni të mos rrezikojë mbylljen, në qoftë se është në shkelje ligjore.

Këto pastaj do t'i bëjmë si iniciativa ligjore ne, dhe kjo është kërkesa e pestë, por, sigurisht, duke mos i harruar në debatin e shtatorit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, se do të më duhet ta mbyll!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Me frekuencat e lira kemi dy problem: njërin e kemi me Ministrinë e Energjetikës, e cila është edhe drejtoria që ka kaluar edhe frekuenca. Ka qenë ministri më vete, ndërsa tani ka kaluar në drejtori të kjo ministri, ndërsa problemin tjetër e kemi me AKEP-in, pasi

jemi i vetmi vend në rajon që nuk kemi nënshkruar marrëveshjen për lirimin e brezit dixhital dividend 2-shit. Ky brez po u lirua t'u kalojë *mobile*-ve, prek pothuajse të gjithë operatorët në Shqipëri. Por ne jemi i vetmi shtet që nuk e kemi nënshkruar marrëveshjen. Pse? Sepse jemi treg shumë specifik.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është specifik, pasi ka shumë televizione, ka një historik të vetin, ka qenë diktatura me thikë, që është përsëri dhe është ky treg që është.

Platformat janë të fuqishme, operatorët kombëtarë janë të fuqishëm, operatorët lokalë, ja ku janë dhe roli i tyre. Domethënë, duhet ta sqarojmë këtë pikë.

Këto shtete deri në vitin 2022 do ta lirojnë atë brez dhe do t'ua kalojnë *mobile*-ve. Ne nuk e kemi nënshkruar fare marrëveshjen deri tani dhe prandaj jemi kështu, si dele e zezë aty.

E dyta, jo të gjitha zonat kanë. Fieri, për shembull, me sa kam dijeni, nuk ka frekuencë, por është një tjetër frekuencë e lirë, VHF, që është kombëtare. Ajo ka specifikat e saj teknike, por është e lirë.

Pra, së pari, do të sqarojmë se çfarë do të bëjmë me këtë brez frekuencash.

Kemi zhvilluar një takim me ministrinë dhe AKEP-in, do të bëjmë edhe një tjetër.

E dyta, si do të dalim? Është e vërtetë se ka zona si Kukësi, Gjirokastra, Elbasani, në mos gaboje edhe Korça, që kanë frekuencë, ka edhe zona që nuk kanë.

Pastaj, logjika është e pastër. Me frekuencën e dytë të RTSH-së, që është për operatorët lokalë çfarë do të bëhet? Ajo është aty, është investuar. Pra, të bëjmë edhe një logjikë ekonomike. Jua thamë këtyre operatorëve: bëjeni prapë. Është aty, është investuar. Nuk ka rëndësi se të kujt janë lekët, se, në fund të fundit, lekët përsëri qytetarëve u merren në fund, si të RTSH-së, si të TOP-it, si të Digitalb-it.

(Deputeti Boçi flet pa mikrofon.)

Një sekondë, zoti nënkryetar!

Hapësirën e hapim, jam gati ta diskutojmë...

Luçiano Boçi – ...se e dëmtuat ju TVSH-në, jo televizionet.

Gentian Sala – Ne nuk kemi dëmtuar asnjë.

Albana Vokshi – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gentian Sala – Për këtë jemi me garanci. Absolutisht asnjë operator...

Luçiano Boçi – Nejse, se ky është debat, nuk ka lidhje me këtë.

Gentian Sala – Si? E hapim, por nuk...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me thënë të drejtën, tani që po implementohet, duket se nuk ka monopol. Hapësirat janë të gjitha aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ideja është që legjislatori e bën ligjin që edhe t'i mbrojnë platformat për gjendjen faktike, që kanë marrë frekuenca të paligjshme, edhe do të jetë si ligji europian, edhe do t'i mbrojnë operatorët, edhe do të mbrojnë pavarësinë e Autoritetit dhe pastaj ngelet pikërisht AMA të vendosë për tregun.

Normalisht, janë futur 100 interesa në njëzet vjet, që është bërë paligjshmëri, por ne japim garanci që ka vend për të gjithë, madje edhe për të tjerë që duan të futen. Thjesht duhet gjetur gjuha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të mos harrojmë se një vit është i paguar nga shteti. Kjo është me ligj që brenda vitit. Domethënë, ne themi që do të filloni ju të paguani tre-katër muaj, këto para do t'ju hidhen mbrapa. S'ka përse, sepse është e paguar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu e ka ligji. Çfarë të të them unë tani?

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Jo, sepse frekuenca ka dalë në shitje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si jepet pas dhjetë vjetësh? Është 100% e sigurt që do të rregullohet brenda vitit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po themi që një vit jemi të garantuar. Pas një viti, hajde, ulemi të flasim.

(Deputetja Mehmetaj ndërhyr pa mikrofon.)

Sapo të zgjidhet frekuenca.

Kejdi Mehmetaj – E keni këtë siguri.

Gentian Sala – Tani, sigurinë... Kjo është siguria, pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Hajde të fitojmë kohë, ulemi në fillim të shtatorit dhe e diskutojmë.

Albana Vokshi – Atëherë, unë shpresoj shumë që kjo tryezë të ketë sjellë një diskutim dhe të ketë sjellë më afër disa zgjidhje të shpejta në mbështetje të televizioneve lokale.

Unë dua të bëj një propozim, të cilin e diskutova edhe me zonjën Ekonomi. Ne si komision, në përfundim të kësaj tryeze, do të bëjmë një letër për AMA-n dhe RTSH-në dhe, nëse duhet, edhe për ministritë përkatëse, ku do të përfshihen një pjesë prej shqetësimeve që ju ngritët në këtë tryezë.

Unë po përmend disa prej tyre, që ne kemi menduar t'i rreshtojmë në letrën tonë:

E para, të shihet shtyrja e procesit të digjitalizimit deri në fund të vitit.

E dyta, organizimi në shtator i një tryeze më të ngushtë, teknike, e cila do të diskutojë një sërë problematikash që u shtruan edhe sot. Sigurisht, edhe çështjen e shtyrjes së procesit të digjitalizimit deri në fund të vitit me përfaqësuesit tuaj, të AMA-s, të AKEP-it dhe të RTSH-së, si dhe me përfaqësues të institucioneve të tjera, që ju do ta gjykoni të domosdoshme të jenë pjesë e kësaj tryeze më të ngushtë;

E treta, të shihet mundësia e rishikimit të tarifave sipas standardeve të caktuara;

E katërta, të shikohet mundësia e një modeli të ri rimbursimi të drejtpërdrejtë;

E pesta, të shikohet monitorimi i vazhdueshëm i shpërndarjes së reklamave shtetërore në të ardhmen, sipas kushteve të vendosura nga BE, siç më njofton Sonila, që ka qenë pjesë e diskutimit në mbledhjen e fundit të nënkomisionit (para një jave, nëse nuk gaboj);

E gjashta, është çështja e propozuar nga operatorët lokalë lidhur me krijimin e një platforme digjitale lokale, të cilën e përmendi edhe zoti Boçi;

E shtata, të studiohet pjesa e gjobave të vëna, që ato të jenë më të arsyeshme, në mënyrë që të mos i mbysim televizionet lokale për disa shkelje, që edhe gjoba të jetë në mënyrë proporcionale me shkeljen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, Genti!

Ky grup i ngushtë teknik që do të krijohet, të shohë nëse ka nevojë të ngrihen edhe grupe të tjera teknike. Kjo është një shkresë zyrtare, që do të dalë nga komisioni dhe do t'u dërgohet institucioneve përkatëse. Të shihet mundësia e kërkesës nga ana e komisionit, ndoshta kur të bëhet rishikimi i buxhetit për vitin 2018, apo edhe në fund të vitit, që të rritet buxheti në mbështetje të televizioneve lokale.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë kaq kam mbajtur shënim. Do t'ju vihet edhe ju në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, edhe frekuencat. Kjo ishte e para që kisha për të thënë.

Unë këto kam mbajtur shënim. Nuk e di nëse më ka shpëtuar ndonjë shqetësim madhor juaji. Shkresa zyrtare do të dalë shumë shpejt nga komisioni dhe ju do të njoftoheni për këtë shkresë.

Në fillim të shtatorit sugjerojmë të mblidhet një tryeze më e ngushtë teknike, e cila do të fillojë nga puna për të shqyrtuar dhe për të zgjidhur pjesë-pjesë, në afate të ndryshme, të gjitha shqetësimet që ju keni.

Duhet të keni parasysh predispozicionin e të gjithë deputetëve. Jam e sigurt se edhe ata, që nuk kanë mundur të vijnë sot për arsye objektive, janë të predispozuar t'ju mbështesin maksimalisht brenda kornizës ligjore.

Edhe ne, nga ana jonë, do të bëjmë maksimumin për t'i nxitur institucionet përkatëse përgjegjëse për të zgjidhur problematikat që janë të zgjidhshme brenda kuadrit të digjitalizimit. U tha këtu se çdo shtyrje e digjitalizimit krijon kosto për RTSH-në, por duhet theksuar se është shkelur çdo afat i vendosur për digjitalizimin deri tani. Minimalisht është shkelur 3 vjet, nëse nuk gabo, procesi i digjitalizimit. Pse të mos u japim një mundësi edhe TV-ve lokale për një shtyrje të afatit, kur juve ju është dhënë 3 vjet kohë? Ne tani po kërkojmë 3 muaj shtyrje, në një kohë kur juve ju është lënë 3 vjet kohë, në shkelje të të gjitha afateve të përcaktuara. Do të doja që me këtë propozim të kryesuesve të komisionit dhe të deputetëve prezentë, ta mbyll këtë takim.

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen!

Do të shihemi shumë shpejt edhe në bashkëpunime të tjera.

Ju uroj suksese!

MBYLLET MBLEDHJA